



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 58

Tiranë – E enjte, 14 prill 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 2, datë 9.2.2016	Mbi mënyrën e organizmit dhe realizimit të procedurave të përqendruara të prokurimit publik “Blerje ushqimesh” për shërbimin social shtetëror dhe institucionet e përkujdesjes shoqërore në Republikën e Shqipërisë..... 3635
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 3, datë 9.2.2016	Mbi mënyrën e organizmit dhe realizimit të procedurave të përqendruara të prokurimit publik “Shërbim me roje civile” për shërbimin social shtetëror dhe institucionet e përkujdesjes shoqërore në Republikën e Shqipërisë..... 3635
Udhëzim i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 13, datë 8.4.2016	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar... 3636
Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 20, datë 4.4.2016	Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 123, datë 2.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 328, datë 27.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 3639
Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 21, datë 4.4.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-4300 (668), datë 11.12.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 3649
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 46, datë 30.3.2016	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive shtesë nga Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a..... 3654
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 47, datë 30.3.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”..... 3655
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 48, datë 30.3.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”..... 3659
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 30.3.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”..... 3659

Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 50, datë 30.3.2016	Për disa ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.....	3660
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 1900, datë 7.4.2016	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II”.....	3661

**UDHËZIM****Nr. 2, datë 9.2.2016**

**MBI MËNYRËN E ORGANIZMIT DHE  
REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË  
PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT  
PUBLIK “BLERJE USHQIMESH” PËR  
SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR  
DHE INSTITUCIONET E  
PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në përputhje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 2, kreu I i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Realizimin e procedurave të prokurimit për “Blerje ushqimesh” me procedurën “Prokurim i përqendruar” nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurës së prokurimit në emër dhe për llogari të Shërbimit Social Shtetëror dhe institucioneve të përkujdesjes shoqërore në varësi të saj.

3. Shërbimi Social Shtetëror duhet të dërgojë pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë specifikimet teknike, sasitë e mallrave/volume që do të prokurohen dhe fondet e vëna në dispozicion brenda datës 15 janar.

4. Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore duhet të marrin për bazë çmime të njëjta për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj (çmimet e INSTAT-it).

5. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit (që nga njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit), ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga secila prej palëve përfituese për sasinë/volumin e mallrave, shërbimeve ose punëve që do të përfitojnë.

6. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dërgon pranë Shërbimit Social Shtetëror, dokumentacionin e plotë në formë të shkruar dhe elektronike (CD) për të vijuar me nënshkrimin e kontratave përkatëse.

7. Shërbimi Social Shtetëror dhe institucionet e përkujdesjes shoqërore të varësisë së saj janë përgjegjëse për ndjekjen e realizimit të kontratës.

8. Ngarkohen, për zbatimin e këtij udhëzimi, Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË  
**Blendi Klosi**

**UDHËZIM****Nr. 3, datë 9.2.2016**

**MBI MËNYRËN E ORGANIZMIT DHE  
REALIZIMIT TË PROCEDURAVE TË  
PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT  
PUBLIK “SHËRBIM ME ROJE CIVILE”  
PËR SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR  
DHE INSTITUCIONET E  
PËRKUJDESJES SHOQËRORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në përputhje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 147, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 2, kreu I i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Realizimin e procedurave të prokurimit me objekt “Shërbim me roje civile”, me procedurën “Prokurim i përqendruar” nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë merr përsipër rolin e Organit Qendror Blerës për zhvillimin e procedurës së prokurimit në emër dhe për llogari të Shërbimit Social Shtetëror dhe institucioneve të përkujdesjes shoqërore në varësi të saj.



3. Autoritetet kontraktore duhet të dërgojnë pranë organit qendror blerës specifikimet teknike, sasitë e mallrave/volume që do të prokurohen dhe fondet e vëna në dispozicion brenda datës 15 janar.

4. Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore duhet të marrin për bazë çmime të njëjta për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj (legjislacioni përkatës për llogaritjet e shërbimit, si: Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, legjislacioni për sigurimet shoqërore, ligji nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe rekomandimet e APP-së dhe KPP-së mbi llogaritjet për një shpenzim të tillë).

5. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është përgjegjëse për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit (që nga njoftimi i kontratës e deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit), ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga secila prej palëve përfituese për sasinë/volumin e mallrave, shërbimeve ose punëve që do të përfitojnë.

6. Pas njoftimit të fituesit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dërgon pranë Shërbimit Social Shtetëror, dokumentacionin e plotë në formë të shkruar dhe elektronike (CD) për të vijuar me nënshkrimin e kontratave përkatëse.

7. Shërbimi Social Shtetëror dhe institucionet e përkujdesjes shoqërore të varësisë së saj janë përgjegjëse për ndjekjen e realizimit të kontratës.

8. Ngarkohen, për zbatimin e këtij udhëzimi, Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË  
**Blendi Klosi**

#### UDHËZIM

Nr. 13, datë 8.4.2016

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 223,  
DATË 19.4.2006, “PËR PAGESËN E SË  
ARDHURËS NGA PAPANËSIA”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të vendimit nr. 223, datë 19.4.2006, të Këshillit të

Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

1. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave, për çdo rast përfitimi, kategoritë përfituese duhet të kenë gjithsej 12 muaj pagese kontributesh të sigurimeve shoqërore në degën e sigurimit të papunësisë, të derdhura nga punëdhënësi.

2. Në zbatim të shkronjës “c”, pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave, jashtë afatit 60-ditor përfituesit e pagesës së të ardhurës nga papunësia e humbasin të drejtën e përfitimit të kësaj pagese, me përjashtim të rasteve kur janë të paaftë për punë, paaftësi e vërtetuar me raport mjekësor ose dokumente shoqëruese, që kanë qenë të shtruar në spital (fletëhyrje dhe fletëdalje nga spitali).

3. Në kategoritë përfituese, të pagesës së të ardhurës nga papunësia përfshihen dhe:

a) Gratë, të cilat përfundojnë trajtimin me të ardhurën e barrë lindjes (jo më parë se 63 ditë pas lindjes) dhe në momentin që kthehen në vendin e punës iu ndërpritet marrëdhënia individuale e punës, që detyrimisht kanë qenë të siguruara për përfitim të së ardhurës nga papunësia për periudhën 12-mujore, përpara fillimit të përfitimit të së ardhurës për barrë lindje.

c) Burrat, përfitues të pagesës së të ardhurës nga papunësia, të cilët e ndërpresin atë për të përfituar përkujdesje për fëmijën (sipas ndryshimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar).

d) Ushtarakët e liruar nga detyra dhe që nuk përfitojnë nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

e) Personat, të cilët janë shkëputur nga puna për arsye të përfitimit të paaftësisë së përkohshme dhe mbas mbarimit të kësaj periudhe, në momentin që kthehen në vendin e punës, iu ndërpritet marrëdhënia individuale e punës, për të cilën detyrimisht kanë qenë të siguruar për përfitim të pagesës së të ardhurës nga papunësia për periudhën 12-mujore, përpara fillimit të përfitimit të paaftësisë së përkohshme në punë.

f) Shtetasit e huaj, që jetojnë në Shqipëri (sipas ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”), trajtohen në kushte të barabarta me shtetasit shqiptarë për



përfitimin e pagesës së të ardhurës nga papunësia. Ata duhet të paraqesin të njëjtat dokumente (sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave), të përkthyer në shqip.

g) Personat që kanë mbyllur aktivitetin si punëdhënës dhe rezultojnë pasiv në organet tatimore, nëse punësohen në një vend tjetër, do të përfitojnë pagesën e së ardhurës nga papunësia dhe llogaritja iu fillon nga periudha që kanë derdhur kontribute të sigurimeve shoqërore, si punëmarrës.

4. Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave, personat që kanë plotësuar kushtet për të përfituar pagesën e së ardhurës nga papunësia, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 9.3.2016, “Për disa ndryshime në vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia” do të konsiderohen si përfitues për herë të parë, por kërkesa do të jetë e vlefshme, vetëm nëse është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore jo më pak se 12 muaj pas përfitimit të mëparshëm dhe vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në varësi të periudhës së kontributit të sigurimit shoqëror, përkatësisht për:

a) 3 muaj përfitim, nëse kanë të paktën 12 muaj kontribute të sigurimeve shoqërore (që nga përfitimi i fundit);

b) 9 muaj përfitim, nëse kanë të paktën 5 vjet kontribute të sigurimeve shoqërore (që nga përfitimi i fundit);

c) 12 muaj përfitim, nëse kanë mbi 10 vjet kontribute të sigurimeve shoqërore (që nga përfitimi i fundit).

5. Për rastet e përsëritura të përfitimit, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar, kategoritë përfituese trajtohen si më poshtë:

a) Në rast të paraqitjes së kërkesës së dytë, për një periudhë të paktën 1 vjeçare të kontributeve të sigurimeve shoqërore, përfitimi i të ardhurës nga papunësia do të jetë 3 muaj.

b) Në rast të paraqitjes së kërkesës së dytë, për një periudhë të paktën 5 vjet të kontributeve të sigurimeve shoqërore, përfitimi i të ardhurës nga papunësia do të jetë 3 muaj.

c) Në rast të paraqitjes së kërkesës së dytë, për një periudhë mbi 10 vjet të kontributeve të sigurimeve shoqërore, përfitimi do të jetë 3 muaj.

Për sa më lart, mbas çdo përfitimi, duhet që periudha e kontributeve në sigurimet shoqërore të jetë të paktën 12 muaj.

6. Në zbatim të pikës 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave, për të përfituar pagesën e së ardhurës nga papunësia, kategoritë përfituese:

a) duhet të paraqesin në zyrën e punësimit dokumentacionin e përcaktuar në këtë pikë;

b) kërkesën me shkrim, e cila duhet të plotësohet brenda 60 ditëve nga lindja e së drejtës së përfitimit të këtyre të ardhurave, që konsiderohet dita e parë e mbetjes pa punë;

c) duhet të konfirmohen të regjistruar si punëkërkues të papunë në zyrën e punësimit;

d) duhet të plotësojnë formularin e dyfishtë, i cili i vihet në dispozicion nga zyra e punësimit dhe konfirmohet nga Sigurimet Shoqërore për të tria rastet e përfitimit për:

- të paktën 12 muaj kontribute të sigurimeve shoqërore;

- të paktën 5 vjet kontribute të sigurimeve shoqërore;

- dhe mbi 10 vjet kontribute të sigurimeve shoqërore.

Sigurimet Shoqërore janë të detyruara të konfirmojnë në formularin e dyfishtë për personat, përfitues të pagesës së të ardhurës nga papunësia, periudhat e mësipërme të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Për periudhën pas vitit 2012, kur Sigurimeve Shoqërore nuk u kanë ardhur listëpagesat nga tatimet, atëherë kontributi për sigurimet shoqërore për këtë periudhë vërtetohet nga Tatimet.

7. Në zbatim të pikës 9, të vendimit të Këshillit të Ministrave, pagesën e së ardhurës nga papunësia nuk e përfitojnë personat, të cilët:

a) janë në marrëdhënie pune;

b) janë punëdhënës ose të vetëpunësuar në qytet dhe në fshat;

c) janë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;

d) janë larguar jashtë shtetit për arsye të ndryshme;

e) janë në përfitim pensioni pleqërie, invaliditeti apo familjar, paaftësie të përkohshme në punë, të të ardhurave nga barrëlindja, nga aksidentet në punë apo sëmundje profesionale, ndihme ekonomike;



h) nuk pranojnë të ndjekin programe punësimi me pagesë të ofruar nga zyra e punësimit, për aq kohë sa zgjasin këto programe, pa argumente të arsyeshme;

i) nuk pranojnë të punësohen në një vend pune të përshtatshëm;

j) largohen nga puna me dëshirën e tyre (Konventa nr. 168 e ILO-s).

8. Fëmijët të cilët janë mbi moshën 15 vjeç (mosha minimale sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë), janë në ngarkim të personit përfitues të së ardhurës nga papunësia dhe që nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor, do të regjistrohen si punëkërkuar të papunë, e vërtetuar kjo nga sektori i shërbimeve të zyrës përkatëse të punësimit.

9. Shkronja “a” e pikës 11, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 19.4.2006, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia” shfuqizohet, pasi ka të bëjë me kompensimet e përfshira në masën e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia (ndryshimet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 24.7.1992, “Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe të lëndëve djegëse”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 274 datë 12.6.1993, “Për kompensimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimit të bukës”, i ndryshuar).

10. Në zbatim të shkronjës “b”, pika 11 e vendimit të Këshillit të Ministrave, përfituesit e pagesës së papunësisë që kanë në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë ose janë të paaftë për punë deri në 25 vjeç, përfitojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave nga papunësia (2.5–5% e 11.000 lekë), por jo më shumë se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind. Kjo shtesë familjare do të paguhet e vërtetuar nga certifikata familjare dhe vërtetimet e shkollave të mesme ose të larta, si dhe nga KMCAP-ja (sipas pikës 3 të nenit 54 të ligjit të Sigurimeve Shoqërore nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar).

11. Kur prindërit janë të divorcuar me vendim gjykatë, shtesën familjare e merr prindi që ka fëmijën në ngarkim.

12. Në rastet e punësimit gjatë periudhës së përfitimit të pagesës së të ardhurës nga papunësia apo gjatë periudhës së kualifikimit/rikualifikimit (me pagese), e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje për një periudhë:

a) brenda 6 muajve, për personat që përfitojnë 3 muaj pagesën e së ardhurës nga papunësia;

b) brenda 18 muajve, për personat që përfitojnë 9 muaj pagesën e së ardhurës nga papunësia;

c) brenda 24 muajve për personat që përfitojnë 12 muaj pagesën e të ardhurës nga papunësia,

por me kusht që të mos merren me shumë se 91 ditë për personat që kanë të paktën 1 vit pune, 275 ditë për personat që kanë të paktën 5 vjet punë dhe 365 ditë për personat që kanë mbi 10 vjet punë.

13. Përfituesi i pagesës së të ardhurës nga papunësia është i detyruar të paraqitet në zyrën e punësimit një herë në muaj për të konfirmuar prezencën e tij ose sa herë thirret nga kjo zyrë me qëllim punësimin e tij.

14. Rastet e përligjura që përfituesi është i justifikuar për mosparaqitje, janë:

a) sëmundje, e vërtetuar me dokumente (fletështrimi në spital);

b) vdekja e një pjesëtari të familjes, e vërtetuar me certifikate vdekje;

c) ndalim nga organet e drejtësisë.

15. Për të gjitha rastet e lartpërmendura, pagesa e së ardhurës nga papunësia nuk do të regjistrohet në listëpagesën e muajit, si e tillë kjo e ardhur do të paguhet në momentin që personi paraqitet në zyrën e punësimit me një nga dokumentet justifikuese. Në rast të kundërt, kjo pagesë do të derdhet në buxhetin e shtetit dhe është e pakthyeshme.

16. Pagesa e së ardhurës nga papunësia caktohet mujore dhe paguhet përpjesëtimisht me numrin e ditëve kalendarike, për kohën që përfituesi ka të drejtë të marrë këtë të ardhur. Pagesa merret një herë në muaj pranë bankës përkatëse, në bazë të marrëveshjes që është lidhur midis SHKP-së dhe kësaj banke. Ajo i jepet vetëm personit përfitues, duke u paraqitur pranë arkës me dokumentin e identifikimit ose në bankomat me kartën e debitit.

17. Periudha, gjatë së cilës përfituesi merr pagesën e të ardhurës nga papunësia njihet



vjetërsi pune e siguruar për efekt pension pleqërie, familjar dhe invaliditeti.

18. Kategoritë përfituese të pagesës së të ardhurës nga papunësia, që punësohen me ndërprerje gjatë periudhës 3-mujore, 9-mujore dhe 12-mujore të përfitimit të së ardhurës nga papunësia, përfitojnë nivelin e të ardhurës nga papunësia, të periudhës në të cilën ata rifuten në skemë.

19. Personat, të cilët e kanë fituar të drejtën e përfitimit të së ardhurës nga papunësia para së të hyjë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 9.3.2016, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 223, datë 19.4.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia” do të trajtohen me nivelin e pagesës se papunësisë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 9.3.2016, “Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga papunësia”.

20. Personat, të cilët e kanë fituar të drejtën e përfitimit të së ardhurës nga papunësia dhe regjistrohen në zyrën e punësimit pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 9.3.2016 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 9.3.2016, do t'i fillojnë efektet financiare që nga momenti i shkëputjes nga puna dhe me masën e nivelit bazë prej 11.000 lekësh, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 9.3.2016.

21. Përfituesit që ndjekin kurse kualifikimi dhe rikualifikimi, përfitojnë pagesën e së ardhurës nga papunësia gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kurseve, në rast se nuk paguhen nga ndonjë burim tjetër për këtë periudhë.

22. Në rast se gjatë kohës së përfitimit të të ardhurave nga papunësia punëkërkuesi i papunë largohet me banim (leje banimi) në një vend tjetër, me kërkesën e tij zyra e punësimit e rrethit ku banon dërgon zyrtarisht dosjen me dokumentacionin përkatës në zyrën e punësimit të rrethit, ku ai është transferuar.

23. Në rast se punëkërkuesi i papunë, i cili qendren e fundit të punës e ka në juridiksionin e një zyre tjetër punësimi nga vendbanimi aktual, pasi të ketë konfirmuar formularin e dyfishtë në organet e sigurimeve shoqërore, ku ka qenë qendra e fundit e punës së tij, fillon procedura e aplikimit dhe caktimi i përfitimit i bëhet në zyrën e punësimit, ku ka vendbanimin aktual.

24. Udhëzimi nr. 1468, datë 26.6.2006, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE  
DHE RINISË  
**Blendi Klosi**

**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 4.4.2016**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo,	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 23.11.-2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 39/5 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Luan Marra

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 123, datë 2.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 328, datë 27.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Luan Marra, i cili ka kërkuar pranimin e



kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

##### I

1. Kërkuesi Luan Marra, me vendimin nr. 107, datë 23.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Beratit, është shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, dhe është dënuar me burgim të përjetshëm.

2. Me vendimin nr. 117, datë 3.3.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin nr. 107, datë 23.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 760, datë 24.6.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

4. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 14, datë 3.5.2011 (nr. 14/2011), i ka shfuqizuar të tria vendimet gjyqësore të mësipërme për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se kërkuesit i është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe gjykatat kanë cenuar nenet 25 dhe 32 të Kushtetutës në lidhje me mënyrën e marrjes së provave. Çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

5. Me vendimin nr. 123, datë 2.3.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur shpalljen fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 79, gjerat “a”, “b”, “dh” dhe 278/2 të Kodit Penal (KP) duke e dënuar përsëri me burgim të përjetshëm.

6. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 328, datë 27.6.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 123, datë 2.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

##### II

8. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij

është zhvilluar sërish një proces i parregullt ligjor gjatë rigjykimit. Më konkretisht, ai ka parashtruar se:

8.1 Vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi vijnë haptazi në kundërshtim me vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës Kushtetuese, në shkelje të detyrimit që kanë gjykatat për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

8.2 Është cenuar e drejta për t’u mbrojtur me avokat gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor të datës 30.10.2006. Në shkelje të neneve 28/1 dhe 31 të Kushtetutës, gjykata e apelit e ka vlerësuar si jo të detyrueshme praninë e mbrojtësit për kryerjen e eksperimentit hetimor. Ajo e ka mbështetur vendimin mbi këtë provë, që është deklaruar nga Gjykata Kushtetuese si e marrë në kundërshtim me standardin kushtetues për mënyrën e marrjes dhe të vlerësimit të provave.

8.3 Është cenuar e drejta themelore për të mos iu nënshtruar torturës, e drejta për të mos dëshmuar kundër vetes, si dhe e drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në kundërshtim me provat shkencore dhe shkresore të administruara në gjykim, të cilat provuan se kërkuesi i është nënshtruar torturës kur ka dhënë deklaratimet e tij, gjykatat e mbyllën hetimin gjyqësor pa realizuar detyrën e lënë nga Gjykata Kushtetuese për vërtetimin e prejardhjes së dëmtimeve të vërejtura të kërkuesit dhe pa dhënë sqarime në lidhje me rrethanat e dëmtimeve të tij.

8.4 Është cenuar standardi kushtetues i prezumimit të pafajësisë dhe në shkelje të nenit 27/1 të Kushtetutës kërkuesi është mbajtur në mënyrë arbitrare në paraburgim mbi paragjykimin se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Megjithëse nga ana e mbrojtjes është kërkuar, në hapje të rigjykimit, revokimi i masës së sigurimit personal, gjykata e ka rrëzuar këtë kërkesë.

8.5 Është cenuar standardi kushtetues i arsytimit të vendimit gjyqësor, për arsye se gjykatat i kanë shtrembëruar faktet dhe provat dhe nuk kanë dhënë argumente ligjore se përse i quajnë të papranueshme provat e paraqitura nga kërkuesi. Vendimet e tyre gjykatat i kanë mbështetur vetëm në deklaratimet e kërkuesit të datës 30.10.2006, të marra nëpërmjet dhunës dhe pa praninë e detyrueshme të avokatit, në





kundërshtim me vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i gjykatës së apelit është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, e shpall si absolutisht të pavlefshëm procesverbalin e deklarimeve të dhëna në datën 30.10.2006 dhe, nga ana tjetër, e citon në vendim si një akt të rëndësishëm të fazës së hetimeve paraprake me rëndësi të veçantë procedurale.

8.6 Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të procesit të parë (përkatësisht vendimet nr. 107/2008 dhe nr. 117/2009) rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore E.Z. është pyetur në cilësinë e dëshmitarit. Ndërkohë nga përmbajtja e procesverbalit të seancës të datës 4.11.2011 (procesi i dytë në shkallë të parë) rezulton se është hera e parë që ai pyetet si dëshmitar, çka nënkupton, sipas kërkuarit, se ai nuk është pyetur në procesin e parë, rrjedhimisht gjykatat kanë shpërdoruar detyrën duke falsifikuar provat.

8.7 Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 4.11.2011, oficeri i policisë E.H. nuk e ka marrë në pyetje kërkuarin, megjithëse ka qenë kompetent për mbajtjen e dosjes, për zbulimin e autorit të ngjarjes dhe personi që ka referuar veprën penale në prokurori për rifillimin e çështjes penale. Nga dëshmia e tij rezulton se atij “nuk i kujtohet se mbi ç’ bazë është bërë referimi i rifillimit të hetimeve.

8.8 Nga procesverbalet e akteve të ekspertimit mjekoligjor rezulton se koha kur ka ndodhur ngjarja është pas orës 23:30 dhe jo ora 19:00 apo intervali kohor 17:40–20:00, të cilave u referohen gjykatat e faktit në vendimet e tyre.

9. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka parashtruar se:

9.1 Gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar si provë dhe nuk ka debatuar mbi procesverbalin e datës 30.10.2006 për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, që është marrë pa praninë e avokatit. Ky procesverbal është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit dhe për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata Kushtetuese për të verifikuar nëse mbi të pandehurin është përdorur dhunë. Ajo ka kryer një hetim të mjaftueshëm lidhur me detyrat e ngarkuara nga Gjykata Kushtetuese në drejtëm të sqarimit të prejardhjes së dëmtimeve të

vërejtura të kërkuarit, si dhe ka korrigjuar shkeljet e evidentuara në gjykimin e mëparshëm ndaj tij.

9.2 Pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar. Kërkesa për revokimin e masës së sigurimit është rrëzuar nga gjykata, e cila ka arsyetuar në lidhje me shkaqet e rrëzimit. Nuk rezulton asnjë e dhënë që gjykatat ta kenë filluar procesin me paragjykimin se kërkuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Gjithashtu, kërkuari e lidh cenimin e këtij parimi me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme, çka nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

9.3 Nga materialet e dosjes gjyqësore, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, vendimet e gjykatave për deklarimin fajtor të tij janë bazuar në një vlerësim të plotë të rrethanave të faktit dhe të provave të shqyrtuara e të administruara në gjykim. Vendimet e kundërshtuara nga kërkuari si të paarsyetuara i plotësojnë kërkesat e nenit 142/1 të Kushtetutës, ndaj pretendimi i kërkuarit për cenimin e këtij neni është i pabazuar.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

10. Kërkuari legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuari ka ngritur sërish pretendime për mënyrën e marrjes së provave gjatë rigjyimit dhe të drejtën e mbrojtjes, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Sipas kërkuarit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë respektuar vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës Kushtetuese dhe nuk kanë korrigjuar shkeljet që kjo e fundit ka gjetur në këtë vendim. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për



shqyrtimin e pretendimeve të mësipërme. Për sa u përket pretendimeve shtesë të paraqitura prej tij (§ 8.6-8.8, *supra*), Gjykata çmon se ai nuk legjitimohet për këto pretendime, pasi ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga ana e gjykatave në gjykimin e zhvilluar ndaj tij.

12. Gjykata në vijim i ka çmuar pretendimet e kërkuarit që lidhen me cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të ligjshmërisë në marrjen e provave në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe detyrimeve që rrjedhin nga vendimi nr. 14/2011 i kësaj Gjykate për korrigjimin gjatë rigjyimit të shkeljeve të evidentuara në këtë vendim.

*B. Për pretendimin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 14/2011 i Gjykatës Kushtetuese*

13. Kërkuarisi ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi vijnë haptazi në kundërshtim me vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me të njëjtin person për kryerjen e së njëjtës veprë penale në shkelje të detyrimit që kanë gjykatat për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas kërkuarit, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 14/2011 e ka kthyer çështjen për rigjykim dhe ka lënë për zbatim disa detyra për gjykatën e shkallës së parë, si: sqarimin e prejardhjes së dëmtimeve të vërejtura tek i pandehuri, si dhe të rrethanave të tjera në të cilat i ndaluarit është marrë në pyetje nga punonjësit e policisë; kryerjen e një hetimi të plotë dhe të pavarur të të gjitha pretendimeve të kërkuarit për ushtrim dhune ndaj tij; provimin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet, duke zbardhur të gjitha elementet e veprës penale. Këto detyra, sipas kërkuarit, nuk janë zbatuar nga gjykatat në rigjykimin e çështjes. Gjithashtu, kërkuarisi ka argumentuar se gjatë rigjyimit nuk janë korrigjuar nga gjykatat e zakonshme shkeljet e gjetura nga Gjykata në vendimin nr. 14/2011 në lidhje me mënyrën e marrjes së provave, konkretisht cenimi i neneve 25, 31 dhe 32 të Kushtetutës.

14. Gjykata rithekson se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet

kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit (*shih vendimin nr. 5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ tjetër me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës apo rishikimin e Kushtetutës), nuk mund të mos pranojë t'i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi. Efekti detyrues i vendimeve të kësaj Gjykate ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata ka theksuar se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në vendimin e saj nr. 14/2011 Gjykata ka nënvizuar se “[...] është provuar në rrugë gjyqësore se i pandehuri Luan Marra është marrë në pyetje në mjediset policore pa praninë e mbrojtësit ligjor dhe se ky i fundit, i thirrur pas përfundimit të pyetjes, më pas ka nënshkruar një deklaratë sipas të cilës i pandehuri kishte pranuar para punonjësve të policisë autorësinë për veprën e kryer. Gjatë gjyimit në shkallën e parë i pandehuri ka pretenduar se është detyruar të nënshkruante deklarin, në të cilin pranonte fajin, si pasojë e dhunës së vazhdueshme të ushtruar ndaj tij nga punonjës policie. Prokuroria ka paraqitur para gjykatës si prova në ngarkim të të pandehurit procesverbalin e pyetjes së tij dhe një eksperiment hetimor, nga të cilat, sipas prokurorisë, provohet fajësia e të akuzuarit. Gjykata çmon se mbrojtësi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit dhe mbi të gjitha, duhet që në çdo rast të kujdeset për interesat e të ndaluarit. Pjesëmarrja e mbrojtësit është një garanci serioze jo vetëm për mbrojtjen e interesave të të ndaluarit ose të pandehurit, por edhe për të garantuar një proces të rregullt ligjor në funksion të dhënies së drejtësisë. Gjykata, për sa më sipër, vlerëson se



ndaj kërkuesit është cenuar standardi kushtetues i parashikuar nga neni 31 i Kushtetutës [...]”.

16. Më tej ajo ka konstatuar se “[...] sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor tek i ndaluari Luan Marra janë vërejtur ekimozja në nofull dhe në shputat e këmbëve. Megjithëse organi procedues e ka vlerësuar pretendimin për përdorimin e dhunës ndaj tij dhe ka urdhëruar ekzaminimin mjekoligjor, nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejshme hetimore për të sqaruar prejardhjen e dëmtimeve të vërejtura, si dhe rrethanat e tjera në të cilat i ndaluari është marrë në pyetje nga punonjësit e policisë. Gjykata vëren se ndonëse të ndodhura para pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për ligshmërinë e marrjes në pyetje të kërkuesit në dhomat e paraburgimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar deri në fund të gjitha rrethanat e çështjes për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim vërehen dyshime serioze për kushtet dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij për veprën për të cilën akuzohet, për rrjedhojë edhe në përmbushjen e standardeve për një proces të rregullt ligjor lidhur me mënyrën e marrjes së provave. Në rastin konkret jo vetëm që ka dyshime serioze se ndaj kërkuesit është ushtruar dhunë për të marrë pohimin e tij, por pretendohet nga ky i fundit se është detyruar të dëshmojë kundër vetvetes, në kundërshtim me ndalimet që burojnë nga nenet 25 dhe 32 të Kushtetutës. Gjykata çmon se në çështjen objekt shqyrtimi si nga Prokuroria, ashtu dhe nga gjykatat nuk janë përmbushur, gjithashtu, detyrimet që burojnë nga konventa në fjalë për një hetim të plotë dhe të pavarur të të gjitha pretendimeve të kërkuesit për ushtrim dhune ndaj tij. Standardi kushtetues në lidhje me procesin e rregullt ligjor gjatë hetimit penal kërkon që organi procedues të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet”.

17. Lidhur me mënyrën e marrjes së provave Gjykata është shprehur në po të njëjtin vendim (nr. 14/2011) se “gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, krabas pohimit që i ka bërë veprës kërkuesi para punonjësve të policisë në dhomat e paraburgimit, kanë konsideruar të besueshëm një eksperiment hetimor ku, sipas tyre, ai ka treguar se si ka ndodhur ngjarja. Gjykata çmon se ky eksperiment i kryer nga organet e policisë, menjëherë pasi kërkuesi ka inkriminuar veten dhe në rrethanat e përshkruara më lart, për më tepër pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, jo vetëm krijon dyshime serioze për ligshmërinë e tij, por vjen në kundërshtim edhe me standardin kushtetues të pranuar

përgjithësisht për mënyrën e marrjes dhe të vlerësimit të provave”.

18. Nisur nga sa më sipër, Gjykata në vendimin nr. 14/2011 ka gjetur shkelje kushtetuese në lidhje me mënyrën e marrjes së dy provave, procesverbalit të marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 30.10.2006 dhe eksperimentit hetimor të zhvilluar po në datën 30.10.2006. Si shkaqe të këtyre shkeljeve janë evidentuar dhënia e deklaratave ku kërkuesi inkriminon veten pa praninë e mbrojtësit, si dhe dyshimet për rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij, për të cilat autoritetet shtetërore duhej të kryenin një hetim të plotë.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se procesverbali i datës 30.10.2006 për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, që është marrë pa praninë e avokatit, është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit dhe për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës, bazuar në nenin 370 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

20. Gjykata konstaton se të njëjten linjë arsyetimi ka përdorur, gjatë rigjyimit, edhe gjykata e shkallës së parë, e cila është shprehur se procesverbali i marrjes në pyetje pa praninë e avokatit i datës 30.10.2006 nuk është pranuar si provë, si akt absolutisht i pavlefshëm, por ky procesverbal është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit, pra për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës (f. 26–27 të vendimit nr. 123/2012). Gjithashtu, gjykata e apelit e ka konsideruar këtë procesverbal si një akt të rëndësishëm të fazës së hetimeve paraprake, me një rëndësi të madhe procedurale, sidomos në rrethanat e çështjes në gjykim (f. 26–27 të vendimit nr. 328/2012).

21. Në lidhje me procesverbalin e marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 30.10.2006, Gjykata rithekson faktin se: a) kërkuesi ka bërë deklaratime nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij (neni 37); b) këto deklaratime i ka bërë pa praninë e avokatit edhe pse kjo ka qenë e detyrueshme (neni 37 dhe neni 128). Në këto kushte ky procesverbal, duke qenë një akt absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 128/1/c, nuk mund të përdorej nga prokuroria për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e deklaratimeve të të pandehurit,



bazuar në nenin 370. Gjithashtu, sipas nenit 37 deklarimet që kërkuesi ka bërë duke inkriminuar veten pa praninë e mbrojtësit nuk mund të shfrytëzohen kundër tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto deklarime të bëra më parë nga kërkuesi nuk mund të përdoren për efekt kundërshtimi apo besueshmërie, pasi nuk janë marrë konform ligjit. Përdorimi i një akti procedural absolutisht të pavlefshëm për të përcaktuar besueshmërinë e të pandehurit do ta bënte të pavlefshëm edhe vlerësimin e besueshmërisë, bazuar në nenin 128/1/c.

22. Eksperimentin hetimor të datës 30.10.2006 dhe aktet e prodhuara prej tij gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të vlefshme, çka sipas saj është pranuar edhe nga mbrojtësi i kërkuesit (*shih faqen 28 të vendimit nr. 123/2012*). Ajo është shprehur se vetë mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar marrjen si provë të eksperimentit hetimor.

23. Në lidhje me argumentin e mësipërm të shprehur nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata vëren se mbrojtësi i kërkuesit e ka kërkuar administrimin e kësaj prove, por për të provuar dhunën, kanosjen dhe kërcënimin nga Policia Gjyqësore (*shih f. 28 e vendimit nr. 123/2012*), ndërkohë që gjykata e shkallës së parë e ka administruar për të provuar fajësinë e kërkuesit si provë kryesore (*shih f. 31 e vendimit nr. 123/2012*). Eksperimenti hetimor i kryer në datën 30.10.2006 ka konsistuar në riprodhimin e ngjarjes përpara organeve të policisë nga vetë kërkuesi, i cili gjatë eksperimentit ka inkriminuar veten pa praninë e mbrojtësit dhe pa praninë e prokurorit, fakte të nënvizuara edhe nga Gjykata në vendimin nr. 14/2011. Sipas rregullave procedurale penale prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ai mund të kërkojë nga Policia Gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në këtë rast Policia Gjyqësore respekton dispozitat për caktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore (neni 304 i KPP-së). Po kështu, sipas nenit 32 të Kushtetutës askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes dhe as të pranojë fajësinë e tij. Kur para autoritetit procedues një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën

deklarime nga të cilat dalin të dhëna për inkriminim në ngarkim të tij, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të shfrytëzohen kundër personit që i ka bërë (neni 37 i KPP-së). Në vështrim të normave të mësipërme procedurale, prania e mbrojtësit ka qenë e detyrueshme, në kushtet kur kërkuesi ka inkriminuar veten gjatë kryerjes së një veprimi hetimor të kryer nga Policia Gjyqësore, siç është eksperimenti hetimor.

24. Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë e ka përdorur procesverbalin e eksperimentit hetimor si provë kryesore gjatë rigjykimit të kërkuesit, megjithëse në vendimin nr. 14/2011 është konkluduar për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së kësaj prove, në kushtet ku kërkuesi ka inkriminuar veten, pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, si dhe në rrethana që ngrinin dyshime për ushtrim dhune ndaj tij e që kërkonin hetim nga autoritetet. Gjykata e shkallës së parë, bazuar në deklaratat e bëra nga kërkuesi gjatë eksperimentit hetimor, ka arritur në përfundimin se është provuar plotësisht që kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet (*shih f. 31 të vendimit nr. 123/2012*). Për pasojë, vendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili mbështetet në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe duhet të shfuqizohet.

25. Megjithëse gjatë gjykimit në shkallën e parë nuk janë respektuar detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 14/2011 i kësaj Gjykate dhe, për rrjedhojë, është cenuar procesi i rregullt ligjor, siç është vlerësuar më sipër, këto shkelje nuk janë korrigjuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Kërkuesi ka ngritur në ankim, ndër të tjera, pretendime për të njëjtat prova, të cilat Gjykata në vendimin e saj nr. 14/2011 i ka cilësuar të marra në kundërshtim me standardet kushtetuese për marrjen e provave. Gjykata e Apelit Vlorë lidhur me këto prova është shprehur se “*procesverbalin e deklarimeve të të pandehurit i datës 30.10.2006 përbën një akt të rëndësishëm të fazës së hetimeve paraprake me rëndësi të veçantë procedurale. Për kryerjen e eksperimentit hetimor prania e mbrojtësit nuk ka qenë e detyrueshme. Pretendimet e të pandehurit për ushtrimin e dhunës dhe torturës ndaj tij gjatë*



eksperimentit hetimor kanë rezultuar të pavërteta. Pretendimet e mbrojtjes për deklarin absolutisht të pavlefshëm të eksperimentit hetimor janë të pabazuara” (shih f. 26-27 të vendimit të gjykatës së apelit). Në përfundim të gjykimit Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 328, datë 27.6.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 123, datë 2.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

26. Po kështu edhe Gjykata e Lartë nuk i ka kontrolluar vendimet e gjykatave të faktit në këndvështrim të respektimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (shih vendimet nr. 79, datë 28.12.2015; nr. 3, datë 26.1.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas Gjykatës procesi konsiderohet i parregullt në kuptimin kushtetues edhe në gjykatat më të larta që kontrollojnë vendimin e shkallës së parë, nëse ato, duke u bazuar në kompetencat që u jep ligji, nuk kanë plotësuar ose nuk kanë korrigjuar shkeljet e konstatuara në vendimin e gjykatës së shkallës së parë në drejtim të standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 24, datë 30.4.2012; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Në këto kushte, Gjykata çmon se në rastin konkret si gjykata e Apelit, ashtu dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues.

27. Standardet që lidhen me mënyrën e marrjes së provave i ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në çështjen *Jannatov kundër Azerbajxhanit* (31.10.2014) ajo është shprehur se “[...] pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten në prova. Në vlerësimin e provave Gjykata

adopton qëndrimin e provës “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Aty ku ngjarja është në dijeninë e autoriteteve, si në rastin e personave nën kontrollin dhe “ruajtjen” (custody) e tyre, presupozime të forta ngrihen nëse ka dëmtime që ndodhin gjatë kohës së ruajtjes. Në fakt, barra e provës u takon autoriteteve për të dhënë një përgjigje bindëse. Gjykata vëren se gjykatat e brendshme janë mbështetur në deklaratat e bëra gjatë hetimit nga ana e aplikantit, në të cilat ai ka pranuar përfshirjen e tij në krim. Megjithatë, aplikanti i ka mohuar deklaratat e tij të bëra gjatë hetimit në gjykatë, duke pretenduar se ato janë marrë nën torturë. Edhe pse gjykata nuk arriti të përcaktojë nëse në rastin konkret kishte një shkelje thelbësore të nenit 3 të konventës në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar të aplikantit ndërsa ishte në paraburgim policor, ajo çmoi se paaftësia e saj për të arritur në ndonjë përfundim, në thelb rrjedh nga dështimi i autoriteteve vendase për të kryer një hetim efektiv mbi pretendimet e kërkuesit për keqtrajtim. Gjykata thekson se aty ku ka dyshime në lidhje me besueshmërinë e një burimi prove, nevoja për të verifikuar këtë provë me prova të tjera është më e madhe. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se këto deklaratime, mbi të cilat janë mbështetur gjykatat e brendshme për dhënien e fajësisë, janë prova me cilësi të dyshimtë. Për sa u përket “rrethanave faktike të çështjes”, Gjykata vëren se gjykata e brendshme nuk ka specifikuar dhe nuk ka shpjeguar se mbi cilat “rrethana faktike të çështjes” është bazuar për të përjashtuar deklaratimet e aplikantit gjatë gjykimit në favor të deklaratimeve të bëra prej tij gjatë hetimit” (shih f. 58, 72, 75, 76 të vendimit).

28. Në çështjen *Schenk kundër Zvicrës* (12.7.1988) GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se përdorimi i regjistrimit të kontestuar si provë nuk e kishte privuar aplikantin nga një proces i rregullt, pasi të drejtat e mbrojtjes nuk ishin shpërfillur: ankuesit i ishte dhënë mundësia, të cilën ai e përdori, për të kundërshtuar vërtetësinë e regjistrimit dhe përdorimin e tij si provë, si dhe mundësia për të ekzaminuar dhe pyetur policin që kishte kryer regjistrimin. Gjykata, gjithashtu, i dha rëndësi faktit se përgjimi i telefonit nuk ishte e vetmja provë mbi të cilën mbështetej dënimi (shih f. 46–48 të vendimit).

29. Për përdorimin në proces të provave materiale të siguruara drejtpërdrejt me anën e keqtrajtimeve, GJEDNJ-ja ka çmuar se provat materiale të siguruara me anë të akteve të dhunës nuk duhet asnjëherë, cilado qoftë vlera e tyre bindëse, të merren si referencë për të provuar



fajësinë e personit. Neni 3 i konventës përmban një të drejtë absolute, ndaj nuk mund të peshohen interesa të tjerë kundër saj, si serioziteti i veprës penale apo interesi publik për ndjekjen efektive penale, sepse një gjë e tillë do të cenonte natyrën e saj absolute. Sipas qëndrimit të GJEDNJ-së, as mbrojtja e jetës së njeriut, as sigurimi i dënimit penal nuk mund të arrihen duke komprometuar mbrojtjen e së drejtës absolute për të mos iu nënshtruar keqtrajtimit të parashikuar nga neni 3. Përdorimi i provave të tilla, të përfutuara në sajë të shkeljes së njëres prej të drejtave absolute që përbëjnë thelbin e konventës, shkakton gjithmonë dyshime të forta lidhur me rregullsinë e procesit, edhe nëse pranimi i këtyre provave nuk ka qenë vendimtar për dënimin e të dyshuarit. Si rrjedhojë, gjykata, në lidhje me pohimin e krimit si të tillë, çmoi se pranimi i deklaratave të përfutuara me anë të akteve të torturës apo me anë të keqtrajtimit të tjera në kundërshtim me nenin 3 e kishte bërë procesin në tërësi të parregullt. Ajo ka shtuar se ishte kështu pavarësisht nga vlera bindëse e deklaratave dhe pavarësisht se pranimi i këtyre deklaratave kishte qenë ose jo vendimtar për verdiktin e fajësisë që ishte dhënë ndaj aplikantit (*shih çështjen Gäfgen kundër Gjermanisë, datë 1.6.2010; §. 165, 167 dhe 176 të vendimit*).

30. GJEDNJ-ja ka theksuar se, megjithëse jo specifikisht të përmendura në nenin 6 të konventës, e drejta për të mos folur dhe e drejta për të mos inkriminuar veten janë përgjithësisht standarde ndërkombëtare të njohura, të cilat qëndrojnë në thelb të nocionit të procesit të rregullt të parashikuar në nenin 6. Qëllimi i tyre qëndron, ndër të tjera, në mbrojtjen e të akuzuarit ndaj detyrimit të papërshtatshëm nga ana e autoriteteve, duke kontribuar në këtë mënyrë në shmangien e keqadministrimit të drejtësisë dhe në plotësimin e qëllimeve të nenit 6. E drejta për të mos e inkriminuar veten presupozon në veçanti që prokuroria në një çështje penale duhet të provojë akuzat ndaj të akuzuarit pa iu drejtuar provave të marra përmes metodave të shtrëngimit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. Në këtë kuptim e drejta është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë që përmban neni 6, paragrafi 2 i Konventës. E drejta për të mos e fajësuar veten kryesisht ka të bëjë me respektimin e vullnetit të

një personi të akuzuar për të heshtur. Siç kuptohet përgjithësisht në sistemet ligjore të palëve kontraktuese të konventës dhe në sistemet ligjore të vendeve të tjera, ajo nuk mbulon përdorimin në procese gjyqësore të materialeve që mund të merren nga i akuzuari nëpërmjet përdorimit të kompetencave detyruese, por që kanë një ekzistencë të pavarur nga vullneti i të dyshuarit, të tilla si, ndër të tjera, dokumentet e përfutuara në bazë të një urdhri, analiza e gjakut apo indeve trupore për qëllime të testimi të ADN-së (*shih çështjen Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 17.12.1996; §. 68, 69, 71, 72 dhe 79*).

31. Në çështjen *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar (5.11.2002)* GJEDNJ-ja ka nënvizuar se vëmendje duhet pasur për respektimin e së drejtës së mbrojtjes, në veçanti nëse aplikantit i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe përdorimin e tyre, si dhe nëse deklaratat e bëra nga aplikanti gjatë bisedave janë bërë vullnetarisht, pa asnjë rreng dhe pa asnjë nxitje për të bërë deklaratat të tilla. Gjithashtu, vëmendje i duhet kushtuar cilësisë së provave, përfshi edhe faktin nëse rrethanat në të cilat janë marrë hedhin dyshime në besueshmërinë apo saktësinë e tyre. Për të vlerësuar nëse një procedurë e ka cenuar thelbin e privilegjit kundër vetinkriminimit, gjykata ka shqyrtuar natyrën dhe shkallën e detyrimit, ekzistencën e çfarëdo mase mbrojtëse përkatëse në këndvështrimin procedural dhe përdorimin e çdo materiali të marrë në këtë mënyrë (*shih për më tepër çështjet Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës, nr. 34720/97, § 54–55, ECHR 2000 XII dhe JB kundër Zvicrës, nr. 31827/96, ECHR 2001–III*).

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, GJykata konstaton se pavarësisht konkluzionit të saj në vendimin nr. 14/2011 për paligjshmërinë në lidhje me mënyrën e marrjes së provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, edhe gjatë rigjyqimit të çështjes ky aspekt i procesit të rregullt ligjor nuk është korigjuar. Gjykatat nuk kanë respektuar vendimin nr. 14/2011 të Gjykatës dhe detyrimet që rrjedhin prej tij për sa i përket mënyrës së marrjes së provave dhe sqarimit të rrethanave në të cilat ato janë marrë nga autoritetet e hetimit paraprak. Duke pasur parasysh rëndësinë vendimtare të këtyre provave për fajësinë e kërkuesit, si dhe rëndësinë e të



drejtave themelore të sipërpërmendura, të garantuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, gjykatat duhej të kishin korrigjuar gjatë rigjyqimit shkeljet e evidentuara nga Gjykata në vendimin nr. 14/2011. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës moszbatimi i vendimit të saj nr. 14/2011 dhe mosriparimi i shkeljeve të konstatuara në këtë vendim e ka bërë të parregullt edhe procesin e rigjyqimit ndaj kërkuesit.

33. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, në kuptim të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mosrespektimin dhe moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi nr. 14/2011 i Gjykatës Kushtetuese nga ana e gjykatave gjatë rigjyqimit të çështjes, është i bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin e vendimeve nr. 123, datë 2.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 328, datë 27.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.<sup>1</sup>

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

Anëtarë pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Luan Marra jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve të gjyqimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Në mbështetje të këtij qëndrimi në vijim paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. Pas rigjyqimit të çështjes penale në ngarkim të tij, si pasojë e shfuqizimit, me vendimin nr. 14, datë 3.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese, të vendimeve penale që e kishin gjykuar dhe dënuar atë, kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar përsëri një proces jo i rregullt ligjor. Sipas kërkuesit, vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi vijnë haptazi në kundërshtim me vendimin nr. 14, datë 3.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatat nuk kanë respektuar detyrimin për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, në rigjykimin e çështjes nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata Kushtetuese, që kanë të bëjnë me: sqarimin e prejardhjes së dëmtimeve të vërejtura tek i pandehuri, si dhe të rrethanave të tjera në të cilat i ndaluar është marrë në pyetje nga punonjësit e policisë; kryerjen e një hetimi të plotë dhe të pavarur të të gjitha pretendimeve të kërkuesit për ushtrim dhune ndaj tij; provimin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i atribuohet duke zbardhur të gjitha elementet e veprës penale. Ai pretendon gjithashtu se nuk janë korrigjuar as shkeljet e gjetura nga Gjykata në vendimin nr. 14, datë 3.3.2011 në lidhje me mënyrën e marrjes së provave, konkretisht cenimi i neneve 25, 31 dhe 32 të Kushtetutës.

3. Ashtu siç arsyeton edhe shumica në vendimin e saj, nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Asnjë organ tjetër, me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe

<sup>1</sup> Gjyqtarët B. Dedja, V. Tusha e F. Hoxha votuan vetëm për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-1593, datë 6.11.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.



kjo lidhet me ndryshimin e praktikës apo rishikimin e Kushtetutës), nuk mund të mos pranojë t'i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi dhe është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj buron nga autoriteti i saj për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih paragrafin 14 të vendimit*).

4. Por në ndryshim nga konkluzioni i arritur nga shumica, vlerësoj se në çështjen konkrete gjykatat e zakonshme gjatë rigjyqimit të çështjes kanë respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe detyrimet që rrjedhin prej këtij vendimi për sa i përket mënyrës së marrjes së provave dhe të sqarimit të rrethanave në të cilat ato janë marrë nga autoritetet e hetimit paraprak.

5. Në çështjen konkrete konstatohet se gjykata e shkallës së parë, në zbatim të detyrave të caktuara në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, është shprehur se procesverbali i marrjes në pyetje pa praninë e avokatit, i datës 30.10.2006, nuk është pranuar si provë, por ky procesverbal është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit, pra për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës (*shih f. 26–27 të vendimit*). Procesverbali i eksperimentit hetimor të kryer nga organet e policisë, i datës 30.10.2006, është kërkuar të administrohet nga vetë kërkuesi në seancën e datës 16.12.2012 për të provuar dhunën e ushtruar nga policia mbi të. Gjykata ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata Kushtetuese për të verifikuar nëse mbi të pandehurin është përdorur dhunë, duke pyetur punonjësit e policisë dhe duke administruar

vendimin e prokurorisë për pushimin e procedimit penal ndaj këtyre punonjësve. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e shkallës së parë ka kryer një hetim të mjaftueshëm lidhur me detyrat e ngarkuara nga Gjykata Kushtetuese në drejtim të sqarimit të prejardhjes së dëmtimeve të vërejtura tek i pandehuri dhe të rrethanave të tjera të marrjes së tij në pyetje. Ajo ka korrigjuar shkeljet e evidentuara në gjykimin e mëparshëm ndaj kërkuesit. Për përdorimin e dhunës gjykata e shkallës së parë shprehet se ka pyetur një sërë punonjësish të policisë, të cilët deklaruan se nuk është përdorur dhunë dhe se procedimi penal i filluar për këtë qëllim është pushuar me vendimin e datës 31.7.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Sipas gjykatës të shkallës së parë deklaratimet e të pandehurit të kundërshtuara nga prokurori cenojnë besueshmërinë e deklaratimeve të dhëna prej tij për sa i takon përdorimit të dhunës nga ana e Policisë Gjyqësore si në ngarkim të tij, ashtu edhe të familjarëve (*shih f. 27 të vendimit*). Po kështu edhe Gjykata e Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen ka evidentuar faktin se sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor tek i pandehuri ka shenja dhune (ekimozja dhe shembje) dhe ka arritur në konkluzionet se “këto dëmtime janë të parëndësishme për jetën [...] nga analiza e aktit të ekspertimit nuk provohet që dëmtimet e konstatuara të jenë ushtruar nga punonjësit e policisë gjatë marrjes së deklaratimeve dhe aq më pak këto dëmtime të kenë qenë të tilla që ta kenë detyruar të pandehurin të pranojë autorësinë e krimi” (*shih f. 22 të vendimit*). Më tej, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka vlerësuar se në rastin konkret pretendimet e ngritura në rekurs nuk janë të bazuara, për rrjedhojë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur.

7. Për pasojë vlerësoj se në rastin konkret gjykatat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Në zbatim të detyrave të lëna me vendimin nr. 14, datë 3.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese, gjykatat e zakonshme kanë hetuar dhe gjykuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit dhe kanë arritur sërish në përfundimin se ai është fajtor, pa i bazuar vendimet e tyre në provat e vlerësuara si të marra në mënyrë të paligjshme nga Gjykata Kushtetuese. Në rigjykimin e çështjes nuk është administruar si provë dhe nuk është debatuar e shqyrtuar si e





tillë procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime i datës 30.10.2006, i kundërshtuar nga kërkuesi për shkak të mungesës së mbrojtësit. Ky akt është përdorur në proces nga prokuroria vetëm për të treguar besueshmërinë e të pandehurit dhe për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës. Gjykatat kanë zbatuar edhe detyrat e Gjykatës Kushtetuese që lidhen me verifikimin nëse mbi të pandehurin është përdorur dhunë, duke hetuar dhe sqaruar prejardhjen e dëmtimeve të vërejtura tek ai. Në procesin e rigjykimit gjykatat e zakonshme kanë zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe i kanë garantuar kërkuesit një proces të rregullt ligjor.

8. Për argumentet e parashtruara më sipër vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Luan Marra është e pabazuar dhe se ajo duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

### VENDIM

Nr. 21, datë 4.4.2016

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 2.11.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 50/10 Akti, që i përket:

KËRKUES: Neshat Sula

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve shoqërore, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-4300 (668), datë 11.12.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Kërkuesi Neshat Sula i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Tiranë me kërkesë për të përfituar pension pleqërie të kategorisë së parë të punës si minator nën tokë, duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës. Kjo kërkesë është refuzuar nga DRSSH-ja me shkresën e datës 7.1.2008, me pretendimin se ai nuk plotëson kriterin ligjor që lidhet me vitet e sigurimit. Kërkuesi ka ndjekur rrugën administrative, duke iu drejtuar Komisionit Rajonal pranë DRSSH-s Tiranë dhe Komisionit Qendror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), të cilat, respektivisht, me vendimet nr. 179, datë 11.3.2008 dhe nr. 331, datë 23.5.2008 kanë vendosur mospranimin e ankimit. Në këto rrethana kërkuesi i është drejtuar me padi gjykatës për shfuqizimin e këtyre akteve administrative dhe detyrimin e ISSH-së që t'i lidhë pension pleqërie për 27 vjet sigurime.

2. Me vendimin nr. 1793, datë 9.3.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 618, datë 1.4.2010, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim.

3. Me vendimin nr. 6885, datë 27.9.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë si të pabazuar në prova e në ligj.

4. Me vendimin nr. 1630, datë 8.7.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 6885, datë 27.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur: Pranimin e



*kërkesëpadisë. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 179, datë 11.3.2008 të të paditurës, DRSSH-së, Tiranë. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit të Komisionit Qendror të Apelit të ISSH-së, Tiranë nr. 331, datë 23.5.2008. Detyrimin e ISSH-së Tiranë dhe DRSSH-së Tiranë t'i njohin paditësit Neshat Sula 27 vjet vjetërsi në punë, sipas shënimeve në publikatën e librezës së punës të paditësit për sa i përket lidhjes se pensionit të pleqërisë në favor të paditësit.”*

5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë DRSSH-ja, Tiranë. Me vendimin nr. 00-2014-668, datë 11.12.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1630, datë 8.7.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 6885, datë 27.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*

## II

6. **Kërkuesi Neshat Sula** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

6.1 Seanca gjyqësore është zhvilluar pa praninë e palëve, pra pa u dëgjuar ato. Në këtë mënyrë është mohuar e drejta e palëve të mbrojnë pretendimet e tyre apo edhe t'i paraqesin gjykatës ndonjë provë të re për krijimin e bindjes së saj.

6.2 Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim çështje që i përkasin kompetencës së gjykatave të zakonshme.

6.3 Vendimi i Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor, pasi ai nuk plotëson standardin e arsytimit. Në vendim nuk jepet asnjë argument për qëndrimin e kësaj gjykate, përkundrazi ajo konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë, duke “harruar” se provat e tij janë akte zyrtare që janë përpiluar nga një nëpunës i shtetit (libreza e punës).

7. **Subjekti i interesuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

7.1 Pretendimi se procesi gjyqësor është zhvilluar pa praninë e palëve është i pabazuar. Në të gjitha shkallët e gjykimit të dyja palët ndërgjyqëse kanë qenë të pranishme dhe kanë paraqitur të gjitha provat dhe argumentet përkatëse, duke mos u cenuar barazia e armëve.

7.2 Në proces nuk është mohuar e drejta e njohjes me provat e paraqitura nga palët dhe ato i janë nënshtruar një hetimi të plotë gjyqësor.

7.3 Nga provat e paraqitura në gjykim rezulton se kërkuesi nuk disponon librezë pune të lëshuar nga HC Fierzë, por nga Drejtoria e Shëndetit Publik Tropojë dhe emri i tij nuk rezulton në regjistrat themeltarë të kësaj ndërmarrjeje. Në kushtet kur të dhënat e librezës së punës bien në kundërshtim me të dhënat e regjistratit themeltar të punonjësve të ndërmarrjes HC Fierzë, kërkuesi, i cili pretendon vitet e sigurimit sipas të dhënave të librezës, ka barrën për ta provuar këtë fakt.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, si një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione materiae* në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, pasi pretendimet e tij *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar që ka parashikuar neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve

9. Kërkuesi ka pretenduar se zhvillimi i seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë pa praninë e palëve dhe pa u dëgjuar ato i ka mohuar të drejtën për të mbrojtur pretendimet e tij.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo



detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimin t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata vëren se me miratimin e ligjit **nr. 49/2012** për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i cili është legjislacioni i ri procedural i zbatueshëm në këto lloj gjykimesh, është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimin të këtyre çështjeve. Sipas nenit 59 të ligjit **nr. 49/2012** pala kundër të cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur

pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes së gjykimin në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimin gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

13. Nga aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për efekte të këtij gjykimi, rezulton se rekursi i subjektit të interesuar kundër vendimit të Gjykatës së Apelit nuk i është komunikuar kërkuetit (në dëftesën e komunikimit rezulton shënimi “adresë e shkurtër”), por vetëm përfaqësuesit të tij, i cili ka deklaruar se ka kryer përfaqësimin në apel dhe se nuk e di adresën e kërkuetit. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë ka proceduar edhe me njoftimin me shpallje. Pas regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, me vendimin e datës 19.11.2014, gjyqtari relator ka caktuar datën 11.12.2014 për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Për këtë qëllim është bërë edhe shpallja përkatëse nga ana e sekretarisë së Gjykatës së Lartë.

14. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se administrata gjyqësore nuk ka marrë të gjitha masat për njoftimin e duhur të kërkuetit. Këto parregullsi nuk janë korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, e cila në aspektin e garantimit të procesit të rregullt gjyqësor ka detyrë edhe marrjen e masave për njoftimin e rregullt të subjekteve që potencialisht mund të preken nga procesi, në mënyrë që debati gjyqësor të zhvillohet në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Është e vërtetë se mbrojtësi të cilit i është bërë njoftimi ka deklaruar se ka kryer përfaqësimin e kërkuetit në apel, por Gjykata e Lartë duhej të verifikonte nëse ai kishte hequr dorë nga përfaqësimi i kërkuetit apo nëse kishte



tagra për përfaqësimin e tij edhe në atë gjykatë, me qëllim që të realizonte efektivisht të drejtën e mbrojtjes së kërkuesit në gjykimin para asaj gjykate. Si rrjedhojë, kërkuesi, për shkak se nuk iu komunikua rekursi i palës tjetër, ishte në pamundësi faktike për të paraqitur kundërrekurs brenda afatit ligjor, çka ka sjellë për pasojë edhe humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 59 të ligjit **nr. 49/2012**.

15. Gjykata vlerëson se edhe pse ligji u garanton të drejtën palëve që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen, moskomunikimi i rekursit nga ana e administratës gjyqësore kërkuesit, ka bërë që ai të mos përfitojë nga këto garanci ligjore, çka e ka vënë në një pozitë të pafavorshme në raport me palën tjetër. Me këtë rast Gjykata thekson dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit **nr. 49/2012** për gjykimin e çështjeve administrative. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike apo mbi bazë dokumentesh, ka detyrimin

të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe barazisë së armëve në gjykim.

16. Në përfundim, Gjykata vlerëson se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë argumentet e tij dhe të mbrohet kundër pretendimeve të palës kundërshtare.

*C. Për pretendimin e cenimit të standardit të gjykatës së caktuar me ligj*

17. Kërkuesi pretendon cenimin e këtij parimi, pasi, sipas tij, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim çështje që i përkasin kompetencës së gjykatave të zakonshme.

18. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për me gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, është vlerësuar se ai lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, ndërsa nxjerrja e konkluzionit mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave, nga vlerësimi i dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Gjatë shqyrtimit të çështjeve ajo nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të anki-



muara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit, pa i ndryshuar ato (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në përputhje me standardet e mësipërme, Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim nuk rezulton që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të ketë administruar ndonjë provë të re apo të ketë bërë një rivlerësim të provave të administruara në gjykimet e faktit dhe më **konkretisht të atyre që lidhen me faktin e provueshmërisë** së periudhës së punësimit të kërkuesit pranë HC Fierzë për periudhën 1973–1988. Kolegji Administrativ ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore, në referim të dispozitave procedurale dhe atyre të ligjit nr. 49/2012, për rrjedhojë ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

*Ç. Për pretendimin e cenimit e standardit të arsyetimit të vendimit*

22. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar standardin e arsyetimit, pasi në vendim nuk është dhënë asnjë argument për qëndrimin e kësaj gjykate. Po ashtu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh se prova e paraqitur nga kërkuesi (libreza e punës) është një akt zyrtar, që është përpiluar nga një nëpunës i shtetit.

23. Gjykata, në analizë të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale, ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë: një parashtrim të përmbledhur të

rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar dispozitat ligjore të zbatuara. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, si dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 39, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih*



*vendimin nr. 39, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Në kuptim të standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-668, datë 11.12.2014, përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në proces. Vendimi përmban edhe vlerësimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me shkaqet e rekursit, si dhe argumentet që e kanë çuar atë në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit nuk është i bazuar.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka cenuar parimin e barazisë së armëve, si një element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
  - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-668, datë 11.12.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
  - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

#### VENDIM Nr. 46, datë 30.3.2016

#### PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE SHITESË NGA BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SHA

Në bazë të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “v” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

#### VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:
    - ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve; si dhe
    - tregtimin për llogari të saj, qoftë dhe në një këmbim valutë, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.
  2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të bëjë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi.
  3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
  4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Gent Sejko



**VENDIM**  
**Nr. 47, datë 30.3.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN  
DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË  
NGA SUBJEKTET FINANCIARE  
JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 4, pika 46 dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “d”, e nenit 1, shfuqizohet.

b) Pas shkronjës “b”, të nenit 2, shtohet shkronja “c” me përmbajtjen e mëposhtme:

“nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

c) Në nenin 3, pas togfjalëshit “subjektet financiare jobanka” hiqet togfjalëshi “dhe agjentët e tyre”.

d) Përmbajtja e nenit 4 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në shkronjën “c”, të pikës 2, para togfjalëshit “personi juridik”, shtohet togfjalëshi “personi fizik ose”.

ii) Pas shkronjës “h” të pikës 2, shtohen shkronjat “i”, “j” dhe “k” me përmbajtje si më poshtë:

“i) “blerja e kredisë” – do të konsiderohet si një nga format e kredidhënies;

j) “subjekt financiar jobankë që blen kredi me probleme” - është subjekti, i cili 100 për qind të portofolit të kredisë e ka të përbërë nga kredi me probleme të blera nga banka ose subjekte të tjera financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

k) “kredi me probleme” – do të ketë kuptimin e parashikuar sipas rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” dhe rregullores “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka.”.

e) Përmbajtja e nenit 5 ndryshon si më poshtë vijon:

i) shkronja “c” e pikës 1, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“licencimin e institucionit të parasë elektronike, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, i cili përveç emetimit të parasë elektronike mund të ushtrojë edhe një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:

i) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

ii) këmbimin valutor; si dhe

iii) shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.”;

ii) shkronja “d” e pikës 1 shfuqizohet;

iii) Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me përmbajtjet e mëposhtme:

“4. Subjektet financiare jobanka mund të ushtrojnë veprimtarinë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, nëpërmjet një ose më shumë agjentëve.

5. Institucionet e parasë elektronike nuk mund të emetojnë para elektronike nëpërmjet agjentëve, por mund të shpërndajnë dhe/ose të ripaguajnë fondet nëpërmjet një ose më shumë agjentëve, të cilët veprojnë për llogari të tij.

6. Subjektet sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, janë përgjegjëse për zgjedhjen dhe identifikimin e agjentëve, si dhe sigurojnë informacionin për:

a) emrin, NUIS<sup>2</sup> dhe adresën e agjentit;

b) emrin dhe numrin e identifikimit të administratorëve dhe personave përgjegjës për kryerjen e veprimtarive në emër dhe për llogari të subjekteve;

c) pastërtinë penale dhe integritetin e personave sipas shkronjës “b”.”

f) Përmbajtja e nenit 6 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Pika 3 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

<sup>2</sup> Numri përkatës i identifikimit të personit të tatueshëm.



“Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, kapitali fillestar minimal i kërkuar për subjektet financiare jobanka që blejnë kredi me probleme është 50,000,000 (pesëdhjetë milionë) lekë.”;

ii) Pika 6 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal, çdo shtesë e mëvonshme e tij si dhe çdo ndryshim në strukturën e kapitalit shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.”.

g) Pika 2 e nenit 7 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Licenca e subjektit financiar jobankë përfshin emrin tregtar të subjektit, numrin dhe datën e lëshimit të saj, si edhe ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive financiare, për të cilat subjekti licencohet.”

h) Përmbajtja e nenit 8 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në pikën 1, pas togfjalëshit “nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre” shtohet togfjalëshi “(sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje).”;

ii) Në pikën 2, shkronjat “b”, “c” dhe “e”, shfuqizohen;

iii) Pas nënpikës “vii” të pikës 2, të shkronjës “j”, shtohet nënpika “viii” me përmbajtjen e mëposhtme:

“në rastin kur individi i propozuar për administrator është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar më sipër, në rast se është e aplikueshme, paraqet në Bankën e Shqipërisë lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008, “Për të huajt”, i ndryshuar.”;

iv) Në nënpikën “viii” të shkronjës “k”, të pikës 2, togfjalëshi “formulari nr. 6” zëvendësohet me togfjalëshin “formulari nr. 7”;

v) Paragrafi i dytë, i shkronjës “p”, të pikës 2, ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive administrative të kontrollit të brendshëm, dhe në veçanti, procedurat që do të përdoren nga agjentët, për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe rregullative për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”.

j) Pika 3 e nenit 12 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë regjistron në regjistrin e subjekteve financiare jobanka listën e agjentëve me të dhënat e këtyre të fundit, të dërguara nga subjektet financiare jobanka sipas formularit nr. 10 të kësaj rregulloreje.”;

k) Përmbajtja e nenit 16 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “e” me përmbajtjen e mëposhtme:

“të kryejë veprimtarinë si agjent në sigurime.”;

ii) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin.”.

l) Përmbajtja e nenit 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Në pikën 1, togfjalëshi “të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d” zëvendësohet me togfjalëshin “të parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “d” dhe “e”;

ii) Pas shkronjës “c”, të pikës 1, shtohet shkronja “d” me përmbajtjen e mëposhtme:

“për kryerjen e veprimtarisë si agjent në sigurime:

i. vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë;

ii. ekstraktin e regjistrit tregtar të lëshuar nga QKR-ja, në të cilin të jetë përcaktuar veprimtaria e kërkuar; dhe

iii. plan biznesin për tre vitet e ardhshme nga veprimtaria.”.

m) Përmbajtja e nenit 21 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Shkronja “g”, e pikës 2, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“g) ndryshim të selisë dhe adresës së tij;”;

ii) pika “b” e shkronjës “k” të pikës 2 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“b. marrëveshja e nënshkruar me shoqërinë, për realizimin e mbështetjes informatike të aktivitetit të subjektit, nëse ka të tillë.”.





n) Kreu III shfuqizohet.

q) Përmbajtja e nenit 31 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Subjektet financiare jobanka, në rast të plotësimit të karakteristikave të institucionit financiar të mikrokredisë ose institucionit të parasë elektronike të përcaktuara në këtë rregullore, kanë të drejtë të kërkojnë të licencohen si institucione financiare të mikrokredisë ose institucione të parasë elektronike, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë kur licencën subjektin si institucion financiar të mikrokredisë ose institucion të parasë elektronike, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si subjekt financiar jobankë.

2. Institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike, ka të drejtë të kërkojë të licencohet si subjekt financiar jobankë, në rast se do të kërkojë të ushtrojë veprimtari të tjera financiare në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë kur licencën shoqërinë si subjekt financiar jobankë, revokon njëkohësisht licencën ekzistuese si institucion financiar të mikrokredisë ose si institucion i parasë elektronike.”.

r) Kërkesa drejtuar Bankës së Shqipërisë për dhënie licence për subjekt financiar jobankë/institucion financiar të mikrokredisë/institucion të parasë elektronike ndryshon si më poshtë vijon:

i) Togfjalëshi “P.s.” zëvendësohet me togfjalëshin “Shënim” dhe togfjalëshi “Rruga e Dibrës, kompleksi “Halili”” zëvendësohet me togfjalëshin “Sheshi “Skënderbej”, nr. 1”.

s) Formularët 2, 3 dhe 8 shfuqizohen.

u) Pas formularit 9 shtohet formulari 10 bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

7. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Gent Sejko**





**VENDIM**  
**Nr. 48, datë 30.3.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN,  
ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE  
MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË  
KËMBIMIT VALUTOR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 43, shkronja “c”, nenit 61, shkronja “b” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar me vendimin nr. 31, datë 6.6.2007, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “j” e nenit 3, neni 5, neni 7, pika 2 e nenit 8, neni 11, pikat 3 dhe 4 të nenit 14, shkronja “c” e nenit 16, shfuqizohen;

b) Emërtimi i kreut II bëhet “Licencimi i subjektit”;

c) Pika 2 e nenit 8 shfuqizohet, ndërsa pika 3 e këtij neni, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Kapitali i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, derdhet në një llogari bankare, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e derdhjes.”;

d) Në pikën 4 të nenit 9, pas togfjalëshit “të parashikuar në nenin 6”, hiqet togfjalëshi “dhe në nenin 7 sipas rastit”;

e) Në pikën 1 të nenit 10, pas togfjalëshit “të parashikuar në nenin 6” hiqet togfjalëshi “neni 7”;

f) Emërtimi i nenit 14 bëhet “Veprimtaria e këmbimit valutor” dhe pikat 3 dhe 4 të këtij neni shfuqizohen;

g) Shkronja “c” e pikës 1, të nenit 16 shfuqizohet dhe shkronja “d” e kësaj pike ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“pajisur klientin me faturë për çdo transaksion këmbimi valutor, si dhe duke ruajtur një kopje të saj”;

h) Përmbajtja e nenit 20, ndryshon si më poshtë vijon:

i) Shkronja “c” e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

“subjekti nuk afishon licencën për ushtrimin e veprimtarisë së këmbimit valutor;”;

ii) Shkronja “d” e pikës 2, ndryshon si më poshtë:

“kambistët e subjektit nuk lëshojnë faturën përkatëse për transaksionet e këmbimit valutor;”;

i) Përmbajtja e nenit 21, ndryshon si më poshtë vijon:

i) Shkronja “c” e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

“ka paraqitur dokumentacion të falsifikuar gjatë procedurës së aplikimit për licencë;”;

ii) Shkronja “e” e pikës 2 ndryshon si më poshtë:

“ushtron veprimtari financiare të tjera pa licencën e Bankës së Shqipërisë;”;

j) Në aneksin nr. 7 pas fjalës “nënshkrimi” shtohet fjala “vula”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Gent Sejko**

**VENDIM**  
**Nr. 49, datë 30.3.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NE  
RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E  
MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59, pikat 2 dhe 3, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,



## VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 25, paragrafi 1, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “b” me përmbajtjen e mëposhtme:

“b) vlerën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përfuara kundrejt shlyerjes së kredive”;

b) Shkronja “b” bëhet shkronja “c”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 dhjetor 2016.

KRYETARI  
Gent Sejko

## VENDIM

Nr. 50, datë 30.3.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË  
RREGULLOREN “PËR  
ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË  
KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E  
BANKAVE TË HUAJA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 57, 58, 61, 68 dhe 70, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

## VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 14.9.2011, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “i” e pikës 2, të nenit 4 dhe pika 4 e nenit 14, shfuqizohen.

b) Neni 17 ndryshon si më poshtë vijon:

i) Emërtimi i nenit ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Fshirja nga bilanci e kredive të humbura”;

ii) Togfjalëshi “fshirja e kredive” bëhet kudo “fshirja e kredive nga bilanci”;

iii) Paragrafi 4 i nenit ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“4. Dosjet e kredive të fshira nga bilanci, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Banka, pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e këtyre kredive.”

c) Pas nenit 19, shtohet neni 19/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 19/1

**Kërkesa të veçanta për trajtimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përfuara nga banka kundrejt shlyerjes së kredive**

1. Bankat hartojnë strategji dhe plane të brendshme, si dhe krijojnë strukturat e përshtatshme për shitjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përfuara kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna.

2. Bankat, në rastet kur nuk mund të shesin pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përfuara kundrejt shlyerjes së kredive brenda vitit të parë të përfitimit të tyre, krijojnë fonde rezervë për mbulimin e humbjeve.

3. Për pasuritë e paluajtshme, fondet rezervë krijohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 7 (shtatë) vite nga data e përfitimit të tyre (marrjes së tyre në pronësi në përfundim të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për kreditë e pashlyera) dhe në nivelin jo më pak se norma në përqindje e vlerës kontabël të këtyre pasurive, sipas tabelës së mëposhtme:

Viti i parë	5%
Viti i dytë	15%
Viti i tretë	30%
Viti i katërt	45%
Viti i pestë	60%
Viti i gjashtë	80%
Viti i shtatë	100%



4. Për pasuritë e luajtshme, bankat krijojnë fonde rezervë në nivelin jo më pak se 100% të vlerës kontabël të pasurisë së luajtshme, në rastet kur nuk mund t'i shesin këto pasuri brenda një viti nga data e përfundimit të tyre.

5. Bankat, për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përfuara deri në muajin dhjetor të vitit 2015, për efekt të llogaritjes së fondeve rezervë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, do të konsiderojnë si vit të parë vitin 2016.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 1.12.2016.

KRYETARI  
Gent Sejko

### **KËRKESË**

**Nr. 1900, datë 7.4.2016**

### **PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksioni i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronat, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Saktësim dokumentacioni”, do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 404,775,788 (katërqind e katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR  
I MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN

Gjon Radovani



## LISTA E NDERTESAVE DHE TROJEVE PER SHPRONESIM NE RRUGEN TRANSBALLKANIKE, VLORE

Sipas VKM se nr. 89, date 03.02.2016

sipas gjurmes se projektit miratuar me vendim nr. 3/37, date 16.06.2006

vlera e ndertimit sipas cmimeve te marra nga ZVRPP

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Siperf Trualli	Siperf ndertimi	Çmimi i Truallit Leke/m <sup>2</sup>	Çmimi i Ndertimit Leke/m <sup>2</sup>	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truall dhe ndertese	Shenime
1	8603	8/163	Vlore	P.P.V	282.97		10,903		3,085,222	0	3,085,222	Plotesim dokumentacioni
2	8603	9/2	Vlore	P.P.V	217.84		10,903		2,375,110	0	2,375,110	Plotesim dokumentacioni
3	8603	9/21	Vlore	Aleksander Tafili	30.53		10,903		332,869	0	332,869	Konfirmuar nga ZVRPP. Urdher Kufizimi)
4	8603	9/22	Vlore	BP Shytaj, Dukaj	196.65		10,903		2,144,075	0	2,144,075	Konfirmuar nga ZVRPP.
5	8602	9/22-nd	Vlore	Zigur Serjanaj	0	45	10,903	32,516	0	1,463,220	1,463,220	Plotesim dokumentacioni
6	8603	18/8/1	Vlore	P.P.V	102.43		10,903		1,116,794	0	1,116,794	Plotesim dokumentacioni
7	8603	18/34/1	Vlore	P.P.V	142.34		10,903		1,551,933	0	1,551,933	Plotesim dokumentacioni
8	8603	18/9/1	Vlore	P.P.V	66.71		10,903		727,339	0	727,339	Plotesim dokumentacioni
9	8603	18/10 T	Vlore	BP Agace	322.9		10,903		3,520,579	0	3,520,579	Konfirmuar nga ZVRPP.
10	8603	18/32	Vlore	Besnik Skendaj	226.1	141.4	10,903	32,516	2,465,168	4,597,762	7,062,931	Konfirmuar nga ZVRPP. Kufizim veprimesh
11	8603	20/142T	Vlore	BP Kalemaj	320.71	101.61	10,903	32,516	3,496,701	3,303,951	6,800,652	Plotesim dokumentacioni
12	8603	20/147	Vlore	Stavri Meci	137.2		10,903		1,495,892	0	1,495,892	Konfirmuar nga ZVRPP.
13	8603	20/122Nd2	Vlore	Stavri Meci		51	10,903	32,516	0	1,658,316	1,658,316	Konfirmuar nga ZVRPP.
14	8603	20/122Nd1	Vlore	Filip Meci		52	10,903	32,516	0	1,690,832	1,690,832	Konfirmuar nga ZVRPP.
15	8603	20/122Nd3	Vlore	Theofan Meci		27	10,903	32,516	0	877,932	877,932	Plotesim dokumentacioni (mungon konturi ne harte)
16	8603	20/122T	Vlore	Mihallaq Meci	56	0	10,903	32,516	610,568	0	610,568	Plotesim dokumentacioni (mungon konturi ne harte)
17	8603	20/23	Vlore	Nuk ka info	94.34		10,903		1,028,589	0	1,028,589	Plotesim dokumentacioni
18	8603	20/42-T	Vlore	Empire Invest Sol SHPK	261.93		10,903		2,855,823	0	2,855,823	Konfirmuar nga ZVRPP.
19	8603	24/149	Vlore	Agim Arifi	170		10,903		1,853,510	0	1,853,510	Plotesim dokumentacioni
20	8603	29/320	Vlore	P.P.V	263.8	194.43	10,903	32,516	2,876,211	6,322,086	9,198,297	Plotesim dokumentacioni
21	8603	29/606/3	Vlore	Nu ka informacion	98.52		10,903		1,074,164	0	1,074,164	Plotesim dokumentacioni
22	8603	29/418	Vlore	Malo Resulaj	272.18	120	10,903	32,516	2,967,579	3,901,920	6,869,499	Saktesim dokumentacioni
23	8603	29/556-G	Vlore	BP Dervishaj	96.69	96.69	10,903	32,516	1,054,211	3,143,972	4,198,183	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	8603	29/498	Vlore	P.P.V	248.68		10,903		2,711,358	0	2,711,358	Plotesim dokumentacioni
25	8603	29/626/1	Vlore	Bp Meleqi	206.56		10,903		2,252,124	0	2,252,124	Plotesim dokumentacioni
25	8604	4/287	Vlore	BP.Gurea, Sharra, Ziu, Resuli, xhaferri	156.88		6,899		1,082,315	0	1,082,315	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	8604	4/120	Vlore	Jorgji Vidhi	361.2		6,899		2,491,919	0	2,491,919	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Urdher kufizimi
27	8604	4/253	Vlore	P.P.V	20		6,899		137,980	0	137,980	Plotesim dokumentacioni
28	8604	4/124	Vlore	P.P.V	269.17		6,899		1,857,004	0	1,857,004	Plotesim dokumentacioni
29	8604	4/125	Vlore	P.P.V	226.66		6,899		1,563,727	0	1,563,727	Plotesim dokumentacioni
30	8604	4/128	Vlore	Bp. Nexhipi	273.05		6,899		1,883,772	0	1,883,772	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	8604	5/29-ND	Vlore	Fanije Bezhani		60	6,899	32,516	0	1,950,960	1,950,960	Konfirmuar nga ZVRPP-ja.
32	8604	5/104	Vlore	P.P.V	72		6,899		496,728	0	496,728	Plotesim dokumentacioni
33	8604	5/105	Vlore	P.P.V	172.98		6,899		1,193,389	0	1,193,389	Plotesim dokumentacioni
34	8604	5/106	Vlore	Fanije Bezhani	44		6,899		303,556	0	303,556	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	8604	5/28-ND	Vlore	Argjend Beg Salaj		42	6,899	32,516	0	1,365,672	1,365,672	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Urdher kufizimi
36	8604	5/118	Vlore	P.P.V	113.38		6,899		782,209	0	782,209	Plotesim dokumentacioni
37	8604	5/115	Vlore	P.P.V	20.43		6,899		140,947	0	140,947	Plotesim dokumentacioni



38	8604	5/39.	Vlore	P.P.V	24.15		6,899		166,611	0	166,611	Plotesim dokumentacioni
39	8604	5/146	Vlore	Qamil Lamce	66.73	42	6,899	32,516	460,370	1,365,672	1,826,042	Konfirmuar nga ZVRPP-ja.
40	8604	5/138	Vlore	Piro Merkuri	105	94.8	6,899	32,516	724,395	3,082,517	3,806,912	Konfirmuar nga ZVRPP-ja.
41	8604	5/121	Vlore	Napolon Prifti	83.79		6,899		578,067	0	578,067	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	8604	5/122	Vlore	P.P.V	24.53		6,899		169,232	0	169,232	Plotesim dokumentacioni
43	8604	5/128-T	Vlore	P.P.V	42.6		6,899		293,897	0	293,897	Plotesim dokumentacioni
44	8604	5/132	Vlore	P.P.V	225.28		6,899		1,554,207	0	1,554,207	Plotesim dokumentacioni
45	8604	5/130	Vlore	P.P.V	69.84		6,899		481,826	0	481,826	Plotesim dokumentacioni
46	8604	27/224	Vlore	Bp.Dauti	350.5		6,899		2,418,100	0	2,418,100	Saktesim dokumentacioni
47	8604	27/262	Vlore	P.P.V	382.07		6,899		2,635,901	0	2,635,901	Plotesim dokumentacioni
48	8604	27/83	Vlore	Thoma Vasili	288.66		6,899		1,991,465	0	1,991,465	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Urdher kufizimi
49	8604	35/94	Vlore	P.P.V	97.3		6,899		671,273	0	671,273	Plotesim dokumentacioni
50	8604	35/95	Vlore	P.P.V	43.1		6,899		297,347	0	297,347	Plotesim dokumentacioni
51	8604	35/115	Vlore	Luigj Alijaj	357.87		6,899		2,468,945	0	2,468,945	Plotesim dokumentacioni
52	8604	35/108	Vlore	P.P.V	106.2		6,899		732,674	0	732,674	Plotesim dokumentacioni
53	8604	35/137	Vlore	Bp. Janina Kona	477.27		6,899		3,292,686	0	3,292,686	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	8604	35/84	Vlore	Mendu Sadiraj	336.54		6,899		2,321,789	0	2,321,789	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	8604	4/335/1	Vlore	Qemal Tringaj	200.3		6,899		1,381,870	0	1,381,870	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
56	8604	4/44-ND	Vlore	Qemal Tringaj		80	6,899	32,516	0	2,601,280	2,601,280	Saktesim dokumentacioni
57	8604	4/45.	Vlore	P.P.V	337.37		6,899		2,327,516	0	2,327,516	Mbivendosje, kufizim veprimesh
58	8604	4/303	Vlore	P.P.V	26.61		6,899		183,582	0	183,582	Plotesim dokumentacioni
59	8604	4/122-ND	Vlore	Sotiraq Vidhaj		82	6,899	32,516	0	2,666,312	2,666,312	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	8604	5/147	Vlore	P.P.V	45.08		6,899		311,007	0	311,007	Plotesim dokumentacioni
61	8604	5/137	Vlore	Muharrem Hameti	77.4		6,899		533,983	0	533,983	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	8604	35/64-ND	Vlore	P.P.V		134	6,899	32,516	0	4,357,144	4,357,144	Plotesim dokumentacioni
63	8604	35/67-ND	Vlore	Haki dhe Xhevo Barjami		128	6,899	32,516	0	4,162,048	4,162,048	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Kufizim veprimesh
64	8604	35/134	Vlore	Bp.Dauti	272.15		6,899		1,877,563	0	1,877,563	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Sigurim padie
65	8605	39/120	Vlore	P.P.V	353.86		8,300		2,937,038	0	2,937,038	Plotesim dokumentacioni.
66	8605	39/57	Vlore	Viktor Jahaj	58.34		8,300		484,222	0	484,222	Konfirmuar nga ZVRPP.
67	8605	39/200	Vlore	Rasim Korkaj	56.68		8,300		470,444	0	470,444	Konfirmuar nga ZVRPP.
68	8605	39/227	Vlore	Rasim Korkaj	376.98		8,300		3,128,934	0	3,128,934	Saktesim dokumentacioni
69	8605	39/18	Vlore	Idai Shehu	140	40	8,300		1,162,000	758,530	1,920,530	Konfirmuar nga ZVRPP. Llogaritur me metoden e koston
70	8605	39/188	Vlore	Bp Nelaj	50.55		8,300		419,565	0	419,565	Plotesim dokumentacioni.
71	8605	39/189	Vlore	B.P Gjilkoka	58	46	8,300	32,516	481,400	1,495,736	1,977,136	Saktesim dokumentacioni
72	8605	39/144	Vlore	Ahmet Sherifaj	35		8,300		290,500	0	290,500	Konfirmuar nga ZVRPP.
73	8605	39/2+1-6	Vlore	Viron Beqaraj		32	8,300	39,404	0	1,260,928	1,260,928	Konfirmuar nga ZVRPP.
74	8605	39/2+1-1	Vlore	Viron Beqaraj Jeto Sinaj		38.7	8,300	39,404	0	1,524,935	1,524,935	Konfirmuar nga ZVRPP.Urdher Kufizimi.
75	8605	39/2+1-2	Vlore	Shkelzen Beqiraj		43	8,300	39,404	0	1,694,372	1,694,372	Konfirmuar nga ZVRPP.
76	8605	39/2+1-7	Vlore	Ahmet Sherifaj		35	8,300	39,404	0	1,379,140	1,379,140	Konfirmuar nga ZVRPP.
77	8605	39/2+1-8	Vlore	Ramiz Skendaj		19	8,300	39,404	0	748,676	748,676	Konfirmuar nga ZVRPP.
78	8605	39/2+1-9	Vlore	Ramiz Skendaj		19	8,300	39,404	0	748,676	748,676	Konfirmuar nga ZVRPP.
79	8605	39/2+1-11	Vlore	B.P Gjilkoka		40	8,300	39,404	0	1,576,160	1,576,160	Konfirmuar nga ZVRPP.
80	8605	39/146	Vlore	Ramiz Skendaj	48		8,300		398,400	0	398,400	Konfirmuar nga ZVRPP.
81	8605	39/13	Vlore	Viron Memaj	110		8,300		913,000	0	913,000	Saktesim dokumentacioni
82	8605	36/53	Vlore	P.P.V	226.95	94	8,300	32,516	1,883,685	3,056,504	4,940,189	Plotesim dokumentacioni.
83	8605	36/128	Vlore	Xhafer Xhaferi	38.6	32	8,300		320,380	1,248,610	1,568,990	Plotesim dokumentacioni



84	8605	36/127	Vlore	Fatjon Veizaj	87	87	8,300	32,516	722,100	2,828,892	3,550,992	Konfirmuar nga ZVRPP.
85	8605	36/52	Vlore	B.P Veizaj	248.18		8,300		2,059,894	0	2,059,894	Saktesim dokumentacioni
86	8605	36/104	Vlore	Hysnie Hoxhaj	99.28	99.28	8,300		824,024	2,510,240	3,334,264	Konfirmuar nga ZVRPP. Llogaritur me metoden e koston.
87	8605	36/145	Vlore	Sokol Mullai	35.56		8,300		295,148	0	295,148	Konfirmuar nga ZVRPP.
88	8605	36/204	Vlore	P.P.V	73.3	34	8,300	32,516	608,390	1,105,544	1,713,934	Plotesim dokumentacioni.
89	8605	36/203	Vlore	Xhevit Mullai	66.36	194	8,300	32,516	550,788	6,308,104	6,858,892	Konfirmuar nga ZVRPP. Llogaritur me metoden e koston.
90	8605	30/102	Vlore	Areti Duni	45.3	65	8,300	32,516	375,990	0	375,990	Konfirmuar nga ZVRPP.
91	8605	30/103	Vlore	Hiqmet Xhyheri	49.18	75	8,300		408,194	2,697,270	3,105,464	Konfirmuar nga ZVRPP.Ndertesha 2 kate. Llog. Me kosto
92	8605	30/96-nd	Vlore	Avjon Bushaj		75				2,724,790	2,724,790	
93	8605	30/132	Vlore	Ferdinant Cobo	31.75		8,300		0	2,503,732	2,503,732	Konfirmuar nga ZVRPP.
94	8605	30/46	Vlore	P.P.V	149	158	8,300	32,516	1,236,700	5,137,528	6,374,228	Plotesim dokumentacioni (mungon konturi ne harte)
95	8605	30/46-nd1	Vlore	Admirim Xhindi		20	8,300		0	563,440	563,440	Plotesim dokumentacioni.
96	8605	30/57	Vlore	Viktor Jahaj	69		8,300		572,700	0	572,700	Plotesim dokumentacioni.
97	8605	30/94	Vlore	Agim Xhyheri	244.06		8,300		2,025,698	0	2,025,698	Saktesim dokumentacioni
98	8605	30/95	Vlore	Bp Xhyheri	186.91		8,300		1,551,353	0	1,551,353	Plotesim dokumentacioni.
99	8605	30/47	Vlore	Ska informacion	55.13		8,300		457,579	0	457,579	Plotesim dokumentacioni.
100	8605	30/1	Vlore	Agron Haxhiraj	902.07		8,300		7,487,181	0	7,487,181	Konfirmuar nga ZVRPP.
101	8605	30/1-ND1	Vlore	Agron Haxhiraj		1149			0	41,322,180	41,322,180	Plotesim dokumentacioni. Llog me metoden e koston
102	8605	30/3-nd	Vlore	Agim Xhyheri		62.55	8,300		0	2,152,870	2,152,870	Plotesim dokumentacioni. Llog me metoden e koston
103	8605	30/10	Vlore	B.p Ziu, Muco, Shahu, Resuli	134.51	62.55	8,300		1,116,433	0	1,116,433	Konfirmuar nga ZVRPP.
104	8605	30/141	Vlore	Hiqmet Xhyheri	62	62	8,300		514,600	2,252,500	2,767,100	Plotesim dokumentacioni. Llog me metoden e koston
105	8605	29/62	Vlore	N.Ziu, F. Muco, J.Shahu, B.Resuli, P.Ballhysa	229.57	62	8,300			2,252,500	2,252,500	
106	8605	29/5	Vlore	N.Ziu, F. Muco, J.Shahu, B.Resuli, P.Ballhysa	151.09		8,300		1,905,431	0	1,905,431	Konfirmuar nga ZVRPP.
107	8605	29/157	Vlore	Bp Ziu Ballhysa Muco Shahu Resuli	195.38		8,300		1,254,047	0	1,254,047	Konfirmuar nga ZVRPP.
108	8605	29/156	Vlore	B.p Xhaferri Sulka	249.09		8,300		1,621,654	0	1,621,654	Plotesim dokumentacioni.
109	8605	29/155	Vlore	Bp Sharra	255.45		8,300		2,067,447	0	2,067,447	Plotesim dokumentacioni.
110	8605	29/114	Vlore	Bp Sharra, Gurga,	353.47		8,300		2,120,235	0	2,120,235	Plotesim dokumentacioni.
111	8605	29/34	Vlore	Sotiraq Mitri	470.77	118	8,300	32,516	2,933,801	0	2,933,801	Plotesim dokumentacioni.
112	8605	29/61	Vlore	Bp Sharra, Gurga,	10.7		8,300		3,907,391	3,836,888	7,744,279	Plotesim dokumentacioni.
113	8605	29/33	Vlore	Llambi Mitri	154.29		8,300		88,810	0	88,810	Plotesim dokumentacioni.
114	8605	29/105	Vlore	Ylli Xhakaj	19.59		8,300		1,280,607	0	1,280,607	Konfirmuar nga ZVRPP.
115	8605	29/160	Vlore	Bp Xhaferri dhe Sulka	340.75		8,300		162,597	0	162,597	Plotesim dokumentacioni.
116	8605	29/272	Vlore	Bp Sharra	38.03		8,300		2,828,225	0	2,828,225	Plotesim dokumentacioni.
117	8605	29/158 (29/273)	Vlore	Bp Sharra, Gurga,	401.4		8,300		315,649	0	315,649	Plotesim dokumentacioni.
118	8605	29/118	Vlore	Asqeri Resuli	10.44		8,300		3,331,620	0	3,331,620	Plotesim dokumentacioni.
119	8605	29/31-ND	Vlore	Asqeri Resuli		99	8,300		86,652	0	86,652	Konfirmuar nga ZVRPP.
120	8605	29/123	Vlore	Bp Sharra, Resuli	47		8,300		0	3,382,050	3,382,050	Plotesim dokumentacioni. Llog me metoden e koston
121	8605	46/28	Vlore	Sotir Kosta	277.67	78	8,300	32,516	390,100	0	390,100	Plotesim dokumentacioni.
122	8605	46/108	Vlore	Lefter Nezha	128.89	101	8,300	32,516	2,304,661	2,536,248	4,840,909	Plotesim dokumentacioni
123	8605	46/130	Vlore	Durim Nezha	99.9	111	8,300	32,516	1,069,787	3,284,116	4,353,903	Plotesim dokumentacioni.
124	8605	46/31	Vlore	P.P.V	148.26	100	8,300	32,516	829,170	3,609,276	4,438,446	Konfirmuar nga ZVRPP.
									1,230,558	3,251,600	4,482,158	Ndertimi 1 kat.Ka nje ndertim pa leje.





											Posedohet B.Jahaj	
125	8605	46/59	Vlore	Ska informacion	40.79		8,300		338,557	0	338,557	Plotesim dokumentacioni.
126	8605	46/94	Vlore	P.P.V	20.41		8,300		169,403	0	169,403	Plotesim dokumentacioni.
127	8605	46/93	Vlore	Servet Hodaj	135.9	89	8,300	32,516	1,127,970	2,893,924	4,021,894	Konfirmuar nga ZVRPP.
128	8605	46/33	Vlore	Lefteri Guberaj	92.86	55.5	8,300	32,516	770,738	1,804,638	2,575,376	Konfirmuar nga ZVRPP.
129	8605	46/35	Vlore	P.P.V	112.99	85	8,300	32,516	937,817	2,763,860	3,701,677	Plotesim dokumentacioni.
130	8605	46/37	Vlore	B.p Llambro	24.5		8,300		203,350	0	203,350	Konfirmuar nga ZVRPP.
131	8605	46/36	Vlore	P.P.V	37.85		8,300		314,155	0	314,155	Plotesim dokumentacioni.
132	8605	46/81	Vlore	Ska informacion	51.5		8,300		427,450	0	427,450	Plotesim dokumentacioni.
133	8605	46/38	Vlore	Pandeli Llambi	41.05		8,300		340,715	0	340,715	Konfirmuar nga ZVRPP.
134	8605	46/100	Vlore	Ska informacion	100.86		8,300		837,138	0	837,138	Plotesim dokumentacioni.
135	8605	46/40	Vlore	Ska informacion	28.73		8,300		238,459	0	238,459	Plotesim dokumentacioni.
136	8605	46/39-nd	Vlore	Spiro Komini		76	8,300	32,516	0	2,471,216	2,471,216	Konfirmuar nga ZVRPP.
137	8605	46/60	Vlore	Ska informacion	16.55		8,300		137,365	0	137,365	Plotesim dokumentacioni.
138	8605	46/101	Vlore	Ska informacion	237.5		8,300		1,971,250	0	1,971,250	Plotesim dokumentacioni.
139	8605	46/103	Vlore	B.P Loshi	100.94	63.6	8,300	32,516	837,802	2,068,018	2,905,820	Konfirmuar nga ZVRPP.
140	8605	46/83	Vlore	Ska informacion	35.53		8,300		294,899	0	294,899	Plotesim dokumentacioni.
141	8605	46/44	Vlore	Trifon Aleks	90.41	74	8,300	32,516	750,403	2,406,184	3,156,587	Konfirmuar nga ZVRPP.
142	8605	46/97	Vlore	Arshi Abazi	121.05	72	8,300	32,516	1,004,715	2,341,152	3,345,867	Konfirmuar nga ZVRPP.
143	8605	46/102	Vlore	Arqile Janka	114.98		8,300		954,334	0	954,334	Plotesim dokumentacioni.
144	8605	46/53+1-2	Vlore	Stiljan Todor		81	8,300	39,404	0	3,191,724	3,191,724	Plotesim dokumentacioni.
145	8605	46/53	Vlore	Lluka Çaçani	109.4		8,300		908,020	0	908,020	Plotesim dokumentacioni.
146	8605	46/53+1-1	Vlore	Jorgaq Çaçani		107	8,300	39,404	0	4,216,228	4,216,228	Konfirmuar nga ZVRPP.
147	8605	49/97-ND	Vlore	Koco Xhaho		80	8,300	32,516	0	2,601,280	2,601,280	Saktesim dokumentacioni.
148	8605	49/258	Vlore	Ektor Xhaho	118.91		8,300		986,953	0	986,953	Plotesim dokumentacioni.
149	8605	49/262	Vlore	Edmon Kordha	6.93		8,300		57,519	0	57,519	Plotesim dokumentacioni.
150	8605	49/75	Vlore	P.P.V	257.21		8,300		2,134,843	0	2,134,843	Plotesim dokumentacioni.
151	8605	49/245	Vlore	P.P.V	108.77		8,300		902,791	0	902,791	Plotesim dokumentacioni.
152	8605	49/248	Vlore	B.p Aliraj	64.92		8,300		538,836	0	538,836	Plotesim dokumentacioni.
153	8605	49/263	Vlore	Bp Vengu	188.27		8,300		1,562,641	0	1,562,641	Plotesim dokumentacioni.
154	8605	49/250	Vlore	P.P.V	70		8,300		581,000	0	581,000	Plotesim dokumentacioni.
155	8605	49/149	Vlore	P.P.V	129		8,300		1,070,700	0	1,070,700	Plotesim dokumentacioni.
156	8605	49/255	Vlore	Ndrim Hoxhaj	15.52		8,300		128,816	0	128,816	Plotesim dokumentacioni.
157	8605	49/143	Vlore	P.P.V	64.92		8,300		538,836	0	538,836	Plotesim dokumentacioni.
158	8605	49/197	Vlore	Hiqmet Nelaj	33.86	64.5	8,300		281,038	2,325,160	2,606,198	Konfirmuar nga ZVRPP. Llog me kosto
159	8605	45/152	Vlore	B.p Xhyheri	159		8,300		1,319,700	0	1,319,700	Konfirmuar nga ZVRPP
160	8605	45/153	Vlore	B.p Xhyheri	306		8,300		2,539,800	0	2,539,800	Plotesim dokumentacioni.
161	8605	45/70	Vlore	P.P.V	120.69		8,300		1,001,727	0	1,001,727	Plotesim dokumentacioni.
162	8605	45/50	Vlore	B.p Llanaj	34.49		8,300		286,267	0	286,267	Plotesim dokumentacioni.
163	8605	45/50-N	Vlore	B.p Llanaj		40	8,300		0	1,335,440	1,335,440	saktesim dokumentacioni. Llog me kosto
164	8605	45/309	Vlore	P.P.V	46.64		8,300		387,112	0	387,112	Plotesim dokumentacioni.
165	8605	45/209	Vlore	P.P.V	54.73	108.2	8,300	32,516	454,259	3,518,231	3,972,490	Plotesim dokumentacioni.
166	8605	45/87	Vlore	P.P.V	98.14		8,300		814,562	0	814,562	Ka nje ndertim pa leje.
167	8605	45/154	Vlore	B.p Xhyheri	335		8,300		2,780,500	0	2,780,500	Konfirmuar nga ZVRPP
168	8605	45/318	Vlore	Bp Lekaj	105.92		8,300		879,136	0	879,136	Konfirmuar nga ZVRPP
169	8605	50/23	Vlore	Edmond Gjokoka	51.86	129	8,300	32,516	430,438	4,194,564	4,625,002	Saktesim dokumentacioni
170	8605	50/24	Vlore	Arjan Dautaj	33.97	133	8,300	32,516	281,951	4,324,628	4,606,579	Konfirmuar nga ZVRPP
171	8605	50/63	Vlore	Ska informacion	331.31		8,300		2,749,873	0	2,749,873	Plotesim dokumentacioni.
172	8605	30/66-ND	Vlore	Djana Fiku		100.9	8,300		0	3,627,290	3,627,290	Konfirmuar nga ZVRPP. Llog me



173	8605	30/67-ND	Vlore	Gjylston Deromemaj		98.4	8,300		0	3,538,820	3,538,820	Konfirmuar nga ZVRPP. Llog me kosto
174	8605	30//11	Vlore	B.P.Sharra	97.28		8,300		807,424	0	807,424	Saktesim dokumentacioni
175	8605	39/2+1-3	Vlore	Agim Koburja	35.5	35.5	8,300	39,404	294,650	1,398,842	1,693,492	Konfirmuar nga ZVRPP.
176	8605	49/11-ND	Vlore	Ska informacion	0	33.37	8,300		0	1,079,870	1,079,870	Plotesim dokumentacioni. Llog me metoden e koston
177	8605	45/51	Vlore	P.P.V	57	0	8,300		473,100	0	473,100	Plotesim dokumentacioni.
178	8605	30/115	Vlore	Lavderim Muka	132	132	8,300	32,516	1,095,600	4,292,112	5,387,712	Saktesim dokumentacioni.
179	8605	39/135	Vlore	Agim Koburja	214	22	8,300		1,776,200	710,770	2,486,970	Konfirmuar nga ZVRPP. Llog me kosto
180	8605	45/71-T	Vlore	B.P.Gjoni	7.03	0	8,300		58,349	0	58,349	Konfirmuar nga ZVRPP.

TOTALI

404,775,788



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë